

BORXHI PUBLIK DHE PAKTI I STABILITETIT DHE ZHVILLIMIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

*Heinz-Dieter Wenzel**
*Jörg Lackenbauer***
*Klaus J. Brösamle****

ABSTRAKT

Politika monetare dhe ajo fiskale janë të lidhura me njëra-tjetrën në mënyra të ndryshme. Kjo është edhe arsyeja që adoptimi i euros si një monedhë e vetme evropiane u shoqërua me krijimin e Paktit të Stabilitetit dhe të Zhvillimit të Bashkimit Evropian, një kuadër ligjor për koordinimin e politikave fiskale të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Në këtë studim, ne do të parashtrijmë një përmbledhje të historisë së prejardhjes të këtij Pakti dhe të shkallës në të cilën shtete të ndryshme aderuan në të.

Më tej, ne do të analizojmë efektet që ka borxhi publik dhe deficitin publik, dhe si përfundim do të shtrojmë pyetjen nëse duhet të kufizohet borxhi publik në një mënyrë apo në një tjetër.

Ndër të tjera prezantohet rasti i koordinimit të politikës buxhetore në kontekstin e veçantë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Pas studimit të kuadrit aktual të Paktit, ne do të hedhim dritë mbi të metat kryesore dhe do të paraqesim propozime të ndryshme për reformë, të cilat shikohen në një këndvështrim kritik. Në fund, ne do të prezantojmë një shembull për një përfaqje më fleksible sipas vendeve për interpretimin e kriterit të deficitit (të bazuar në një algjebër të thjeshtë).

1. HYRJJE

Politika monetare dhe ajo fiskale janë të lidhura me njëra-tjetrën në mënyra të ndryshme. Kjo është edhe arsyeja që adoptimi i euros si një monedhë e vetme evropiane u shoqërua me krijimin e Paktit të Stabilitetit dhe Zhvillimit të Bashkimit Evropian, një kuadër ligjor për koordinimin e politikave fiskale të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Që prej hyrjes në fuqi të një monedhe të vetme të Bashkimit Evropian, qëllimi i këtij Pakti ishte parandalimi i deficiteve të tepruara publike nga ana e shteteve anëtare. Kjo mendohet se ishte e nevojshme, sepse nëse politika e një shteti anëtar të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (EMU) është shumë dorëlëshuar, kjo mund të ndikojë në mënyrë të kundërt shtetet e tjera anëtare (për shembull, nëpërmjet rritjes së normave të interesit), dhe në këtë mënyrë do të dëmtonte besueshmërinë në stabilitetin ekonomik të Eurozonës. Financat e shëndosha publike ndonjëherë konsiderohen si një kusht i domosdoshëm për stabilitetin e çmimeve dhe si një përdorim i kujdesshëm i instrumenteve të politikës monetare nga bankat qendrore respektive (në EMU: Banka Qendrore Evropiane (ECB)).

Në vitin 1992, vendet e Bashkimit Evropian vendosën të ashtuquajturat kriteret e konvergencës (ose siç quhen ndryshe “kriteret e Mastrohut”) për anëtarësimin në Eurozonë. Këto kriteret përfshijnë financa të shëndosha publike, kurs të qëndrueshëm këmbimi dhe norma të ulëta interesi. Në atë kohë (ish) Qeveria Gjermane (e kryesuar nga Kristian-Demokratët) ishte e shqetësuar nga fakti se disa vende (veçanërisht vende nga Evropa Lindore të quajtura me përçmim si “club Med” në atë kohë) mund të dështonin po të ndiqnin financat e tyre kur të bëheshin pjesë e Eurozonës. Në dhjetor 1996, me iniciativën e ish-Ministrit Gjerman të Financave, Theo Waigel, Presidenca Evropiane e kryesuar nga Dublini arriti në një konsensus politik mbi elementet përbërëse të Paktit të Stabilitetit. Kjo i hapi rrugën pranimit zyrtar të këtij Pakti në Samitin (European Council) e Amsterdimit, në korrik të vitit 1997: Rezoluta e Paktit u pranua zyrtarisht, duke krijuar një sistem me sanksione për vendet anëtare, të cilat dështonin në mbajtjen e deficitit buxhetor nën 3 për qind të PBB-së, për tre vitet në vazhdim. Në këtë mënyrë, fuqia ligjore e kriterëve të Mastrohut u zgjerua për të shërbyer si një nga shtyllat e themelimit të një mase parandalimi në mbarë Bashkimin

Ekonomik dhe Monetar, qëllimi i së cilës ishte disiplina buxhetore (Komisioni Evropian, faqe 18-19).

Dihet që shumë vende nuk kanë aderuar në rregullat e Paktit të Stabilitetit dhe të Zhvillimit që prej fillimit të tij. Jo më vonë se viti 1998, Italia pati vështirësi në mbajtjen e deficitit të saj buxhetor poshtë nivelit 3 për qind të PBB-së. Në vitin 2001, Portugalia u detyrua të rishikonte shifrën e raportuar prej 2.2 për qind – në fund të vitit 2001 deficitit arriti në 4.4 për qind. Më vonë Gjermania dhe Franca deklaruan se kishin një deficit buxhetor më të lartë se kufiri prej 3 për qind i PBB-së së tre viteve të fundit (2002, 2003 dhe 2004). Prandaj, në këto kushte u zbatuan Procedurat e Buxhetit të Tepruar (të përcaktuara sipas nenit 104 të Traktatit që themelon Bashkimin Evropian) për të dyja këto shtete. Edhe këtë vit, këto dy shtete janë në prag të thyerjes të këtij kufiri; ndërsa Italia, Holanda, Portugalia dhe vende të tjera duket se do të ndjekin po këtë rrugë (Komisioni Evropian, 2004). Një nga qëllimet kryesore të paktit “një pozicion afatmesëm buxhetor i balancuar ose në suficit” - vazhdimisht nuk është marrë parasysh ose të paktën është shtyrë për më vonë nga shumë vende. Rasti më i fundit mbresëlënës i mosrespektimit të rregullave të Paktit të Stabilitetit dhe Zhvillimit vjen nga Greqia, ku qeveria e parizgjedhur socialiste e Pasokut u akuzua për rregullim sistematik të deficitit buxhetor me një zbritje me 2 pikë përqindje, me qëllim që ta mbante atë (në mënyrë artificiale) poshtë kufirit prej 3 për qind. Nëse akuzat do të vërtetohen, Greqia ka thyer vazhdimisht kufirin prej 3 për qind prej vitit 2000 deri në vitin 2003 (kur deficitit arriti 4.6 për qind të PBB-së) dhe është duke bërë të njëjtën gjë (është parashikuar 5.7 për qind 2004). I bie që Greqia asnjëherë të mos ketë vepruar sipas rregullave të paktit, që nga fillimi i ekzistencës së tij. Tani dihet nga të gjithë se Greqia nuk ka aderuar as në kriteret e Mastrohut, në 1998 dhe 1999 – vitet e referencës për pranimin e euros prej saj (Hagelüken, 2004a, 2004b and 2004c; Schlötzer, 2004).

Sic duket Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit nuk funksionon sipas qëllimit të krijimit të tij. Që prej hyrjes në fuqi, ai ka qenë subjekt diskutimesh të kundërta akademike dhe politike. Disa nga pikat kryesore të kritikave përfshijnë arbitraritetin e deficitit dhe të kriterëve të borxhit, fokusin e paktit mbi qëllimet afatshkurtra, kompozimin e tij asimetric, faktin që ai shpërfill qëndrimin e

përgjithshëm fiskal, mekanizmat e dobët detyruës dhe fleksibilitetin e tij të kufizuar. Si rrjedhojë, literatura akademike ka sjellë shumë propozime për reforma, duke filluar nga kompozime totalisht të reja deri në adoptime të rregulloreve aktuale. Megjithatë, e meta kryesore e shumë propozimeve është nevoja e tyre për arsyetim të plotë ekonomik të pavarur nga kompromisi aktual politik. Në këtë këndvështrim, shumë artikuj në mënyrë indirekte supozojnë gjithashtu se disa lloje instrumentesh për disiplinën fiskale – për çdo lloj arsye – janë të nevojshme në një bashkim monetar (në këtë rast Bashkimi Ekonomik dhe Monetar), se ka disa arsye ekonomike për kufizimin e borxhit/deficitit, ose se kuadri ekzistues në parim është i saktë (për arsyen e ekzistencës së tij të thjeshtë) dhe se vetëm ndryshime të lehta mund ta bëjnë atë një instrument optimal fiskal. Një prej qëllimeve kryesore të këtij studimi është të hetojë nëse duhet kufizuar në njëfarë mënyre borxhi publik, domethënë nëse ka një *raison d'être* për Paktin e Stabilitetit në vetvete. Dhe nëse ka, cilat rregulla janë eficientë dhe të qëndrueshëm.

Pjesa tjetër e studimit është e organizuar si më poshtë. Në kapitullin 2, ne do të analizojmë se cilat janë efektet e borxhit publik dhe të deficiteve publike dhe nëse ky borxh duhet të kufizohet. Ndër të tjera, nënvizohet shembulli për koordinimin e politikës buxhetore në kontekstin e veçantë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Në kapitullin 3, do të shqyrtojmë kuadrin aktual të Paktit të Stabilitetit dhe të Zhvillimit. Në kapitujt 4 dhe 5, do të hedhim dritë mbi të metat e tij kryesore dhe do të prezantojmë propozime të ndryshme për reformë, të cilat shikohen në mënyrë kritike. Në kapitullin 6, do të prezantojmë një shembull për një përfaqje më fleksible sipas vendeve për interpretimin e kriterit të deficitit, bazuar mbi një algjebër të thjeshtë. Në kapitullin 7 paraqiten konkluzionet.

2. BORXHI PUBLIK DHE POLITIKA FISKALE NË EKONOMITË E MBYLLURA DHE TË HAPURA

2.1 Borxhi publik në një ekonomi të mbyllur.

Zor se gjendet ndonjë argument tjetër në fushën ekonomike që të jetë diskutuar në mënyra kaq kundërshtuese me njëra-tjetrën sesa

roli i borxhit publik. Që në mes të shekullit XVIII, David Hume (1777) ka konstatuar se “shteti duhet të zhdukë kredinë publike ose përndryshe kredia publike do ta zhdukë shtetin”. Krejt në të kundërtën, Carl Dietzel deklaroi fuqishëm 100 vjet më vonë (1855) se “huamarrja publike është... leva për progres të fuqishëm ekonomik dhe kështu... pikëpamja e Arkimedit, e cila lëviz botën nga boshti i saj”.¹ Dhe 100 vjet më vonë, në shekullin XX, situata paraqitet krejt ndryshe, duke qenë se politika fiskale dhe ajo ekonomike janë të sunduara në mënyrë të ndërsjelltë nga modeli Kejezian dhe ai monetarist – neoklasik. Nëse mendohet për rregulla, të cilët mund të kufizojnë borxhin publik, si për shembull Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit, atëherë duhet së pari të analizohen ndërlidhjet e huamarrjes publike.

Në këtë kontekst, duhet t’i kushtohet vëmendje faktit se analizat mbi efektin e borxhit publik janë kryer si një incidencë diferenciale. Kjo do të thotë se për grupe të ndryshme shpenzimesh të dhëna, ndikimet e instrumenteve alternative të financimit duhet të krahasohen me njëri-tjetrin. Në të kundërt ekziston rreziku i goditjes së borxhit publik si në rastin e kutisë para pasqyrës, kur oponenti aktual është shpenzimi publik.

Efektet shpërndarëse të borxhit publik

Huamarrja publike çon në një rishpërndarje të të ardhurave midis taksapaguesve dhe atyre që marrin interesin. Nëse kreditorët e sektorit publik dhe taksapaguesit nuk janë të njëjtët agjentë ekonomikë, atëherë borxhi publik – ceteris paribus (nëse kushtet e tjera nuk ndryshojnë) – do të shkaktonte një rritje të pabarazisë së shpërndarjes të të ardhurave personale. Ky argument nuk del shpesh në skenë dhe nuk është shumë i besueshëm. Megjithatë, pasaktësia këtu qëndron në faktin se incidenca e huamarrjes publike ngatërrohet me atë të formimit të mirëqenies.

Ky argument bëhet edhe më absurd, kur njerëzit flasin për “garantimin e të ardhmes së nipërve tanë”.² Në fakt, brezat e ardhshëm janë marrësit e pagesave të interesit si edhe ata që do të paguajnë taksat e nevojshme për këtë fund: ne i detyrohemi vetes tonë.

Nëse ka efekte specifike shpërndarëse të borxhit publik, atëherë këto duhen kërkuar në ndryshimin e shpërndarjes funksionale të të ardhurave dhe si rrjedhojë, në ndryshimin e shpërndarjes të të ardhurave personale. Dhe, siç u theksua edhe në fillim, këto efekte mund të maten në kushtet e një incidence diferenciale. Nëse ne supozojmë se një financim nëpërmjet taksave vendos një barrë më të rëndë në konsumin aktual sesa financimi me obligacione (bond), atëherë kjo çështje, e cila në literaturë gabimisht quhet “iluzioni i borxhit”, është mekanizmi nxitës për një ndryshim në shpërndarjen funksionale të të ardhurave dhe si rrjedhojë, pa dyshim edhe në shpërndarjen e të ardhurave personale. Si pasojë, konsumatorët për shembull, ata me një një përqindje preference të lartë kohe do të përfitojnë më shumë nga financimi me obligacione, duke qenë se vlera aktuale e detyrimeve të ardhshme të taksave do të jetë më e ulët sesa humbja e të ardhurave të sotme, shkaktuar nga një financim aktual nëpërmjet taksave.

Kështu që, ne zbulojmë që borxhi publik ka ndikime ndërkohore shpërndarëse, që këto ndikime ndryshojnë nga ato të financimit me taksa dhe që në asnjë mënyrë vlerësimi i tyre nuk duhet të jetë më negativ sesa ai i financimit me taksa.

Nëse ne pranojmë parimin e ekuivalencës ndërkohore, i cili – si një parim “paguaj sa harxhon”- është i bazuar në idenë se ata që përfitojnë nga shpenzimet publike duhet gjithashtu, të marrin pjesë në financimin e tyre, atëherë do të kemi një tregues për shtrirjen e saktë të borxhit publik. E thënë më qartë, marrja e këtij parimi si një tregues është deklaratë normative. Si përfundim ne mund të themi së bashku me Lorenz Von Stein (1871) se “një qeveri pa borxhe ose kërkon shumë nga e tashmja ose bën shumë pak për të ardhmen”.³

Efektet shpërndarëse të borxhit publik

Nga ajo çka u tha më sipër, rezulton se është problematike ta mendosh borxhin publik në terma të të ardhurave si një shtyrje që i bëhet barrës fiskale në të ardhmen. Një shtyrje e barrës së klasave në të ardhmen mund të rezultojë vetëm nga një formim ceteris paribus i kapitalit më të ulët real (si pasojë e borxhit publik), i cili zvogëlon mundësitë e konsumit të të nesërme. Por, ky argumentim kundër

borxhit publik gjithashtu, vuan nga gabimi se një stok më i lartë kapitali në të ardhmen në vetvete, shihet si një rritje e dobishmërisë (utility-increasing). Parë nga një këndvështrim tjetër, ky argumentim do të thotë: ky është maksimizimi i dobishmërisë për të konsumuar asgjë sot por çdo gjë nesër. Kjo bën të qartë se e vërteta duhet të jetë diku në mes. Me fjalë të tjera, duhet të jetë një rrjedhje optimale ndërkohore midis dobishmërisë dhe konsumit.

Në literaturën e financës publike janë përfutur (për shembull Wenzel, 1992a; Wenzel and Wrede, 1993) kushtet për ekzistencën e ekuilibrit të rritjes së qëndrueshme të maksimizimit të konsumit me borxhin pozitiv publik. Këto rezultate bëjnë të qartë se nuk është e vërtetë gjithashtu, të thuash se borxhi i sotëm është taksa e nesërme, duke qenë se borxhi dhe PBB-ja mund të rriten në një kohë, pa reduktuar hapësirën e qeverisë për manovra dhe pa çuar detyrimisht në një ulje të borxhit.

Analiza e borxhit publik në kuadër të modeleve të zhvillimit gjithashtu, tregon se çdo formulim mbi nivelin “e duhur” të borxhit publik varet nga kushtet mbizotëruese teknologjike dhe të traditës. Në veçanti, mund të përmendet elasticiteti i prodhimit të funksionit makroekonomik të prodhimit, tendenca e popullsisë për të kursyer si dhe përqindja e shpenzimeve për investime publike. Madje neni 115 i ligjit bazë të Gjermanisë (Grundgesetz), i cili kufizon shtrirjen e huamarrjes vjetore publike sipas nivelit të shpenzimeve për investime publike, duhet të vlerësohet në mënyrë kritike nën këto supozime.

Ka një tjetër grup argumentesh në favor të financimit të shpenzimeve publike. Ato burojnë nga barra e rëndë e financimit alternativ me taksa.

Dihet që – me përjashtim të taksave të mëdha – të gjitha taksat çojnë në humbje të eficiencës, të cilat madje rriten në mënyrë kuadratike në raport me normën e taksave. Në këtë mënyrë, nëse huamarrja publike çon në detyrime për interesa të së ardhmes dhe për ripagesa, pagesat mund të kryhen me një maturim të zgjatur dhe me norma taksash më të ulëta, dhe kështu do të rritet eficiencia.

Gjashtë tezat në lidhje me borxhin publik në një ekonomi të mbyllur

Midis rreshtave të arsytimit tonë në kapitujt e mëparshëm, ne mund të përmbledhim argumentet tona në lidhje me borxhin publik në një ekonomi të mbyllur duke propozuar këto 6 teza:

1. Kur analizohen ndikimet e borxhit publik, është ekonomikisht absurde të fillosh nga supozimi që shuma e deficiteve të zbritura është zero.
2. Borxhi i sotëm publik nuk është domosdoshmërisht borxhi i të nesërmes.
3. Problemi është më tepër “gracka e shpenzimeve” sesa “gracka e borxhit”.
4. Deficitet duhet “të rriten” sesa “të ruhen”.
5. Debati mbi borxhin publik të kujton rutinë para pasqyrës: borxhi publik dëmtohet, ndërsa oponenti aktual është shpenzimi publik.
6. Huamarrja publike funksionon si një kontratë midis brezave; shfuqizimet dhe kohëzgjatjet e kontratave nuk janë pareto-superiore.

2.2 Borxhi publik dhe politika fiskale në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

Në këtë pjesë do të shqyrtohen politikat fiskale në një bashkim monetar (në veçanti në Bashkimin Monetar dhe Ekonomik) në 3 aspekte: në ç'mënyrë politika kombëtare fiskale influencën anëtarët e tjerë të Bashkimit Monetar dhe Ekonomik; si i ndryshon pjesëmarrja në Bashkimin Monetar dhe Ekonomik stimujt për administrimin e deficitit dhe në lidhje me këtë, si ndryshon rreziku i mospagimit dhe nevoja e nxjerrjes nga balta. Në këtë kuadër, nënkapitujt shqyrtojnë rastet për koordinimin e politikës dhe kufizimet e deficitit.

Eksternalitete dhe të papritura.

Ka një mendim të përgjithshëm se politika fiskale nën një regjim të fiksuar të kursit të këmbimit dhe të një politike të centralizuar monetare, ka efekte të jashtme që ndikojnë vendet e tjera në një bashkim monetar.⁴ Zakonisht, përmenden tre kanale për këto lloj

eksternalitetesh: tregtia brenda Bashkimit Ekonomik dhe Monetar; norma e interesit në mbarë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar dhe kursi i këmbimit të euros (Brunila, 2002, p. 3; Buti and Sapir, 2004, f. 139). Përpara se të përmbledhim pikat e zakonshme, ky kapitull do të fillojë me identifikimin e njërit prej efekteve më të papërfillura nëpërmjet kanalit të tregtisë: inflacioni i importuar dhe prishja e llogarive korente të vendeve të tjera që rrjedhin prej tij.

Kanali i tregtisë dhe inflacioni i importuar

Për ilustrim është e nevojshme të diferencohen çmimet e mallrave të tregtueshëm (p^T) dhe të patregtueshëm (p^N) në një vend vatër (home) (H) dhe partnerëve të tij (F). Zgjerimi fiskal në një vend vatër (H) rrit çmimet e brendshme, nëse nuk ndodh grumbullim i plotë (p^N_H dhe p^T_H rritet). Nën një regjim të fiksuar të kursit të këmbimit, partnerët tregtarë të një vendi në zgjerim duhet të importojnë inflacion nëpërmjet mallrave të tregtueshëm më të shtrenjtë (p^T_F rritet). Importet më të shtrenjta ulin nivelin e dobisë së F , sepse pagat reale ulen për të gjithë ata individë që blejnë importe. Duke konsideruar normën e përgjithshme të inflacionit të një vendi – i si:

$$\pi_i = \tau_i p_i^T + (1 - \tau_i) p_i^N,$$

dhe π është pesha e mallrave të tregtueshëm në konsumin e përgjithshëm, ($0 < \pi < 1$), rezulton se në një kohë afatshkurtër $\pi_H < \pi_F$. Kjo është ekuivalente me vlerësimin e monedhës së vendit H . Në periudhë afatshkurtër, kur kushti i Marshall-Lerner⁵ nuk funksionon, kjo do të përmirësojë bilancin e H dhe do të përkeqësojë bilancin tregtar të vendeve të tjera. Normalisht, efekti i kundërt mund të vendoset sapo agjentët të reagojnë në vendosjen e çmimeve të reja relative për mallrat e tregtueshëm (kushti i Marshall-Lerner funksionon në periudha afatgjata).

Por, çështja kryesore në këtë rast është se dy proceset e përshtatjes ndodhin njëherësh, duke krijuar një rezultat të pafavorshëm për vendet e tjera. Ndërsa importuesit e huaj fillojnë të reagojnë ndaj vlerësimit real, pagat u përshtaten importeve më të shtrenjta. Kjo rrit p^N_F dhe nënkupton që përfundimisht $\pi_H < \pi_F$. Në këtë mënyrë, vlerësimi real korrigjohet dhe si rrjedhojë, konsumatorët në vendet F vazhdojnë të

blejnë mallra të tregtueshëm. Në fund, partnerët tregtarë të F kanë mbetur me një inflacion më të lartë dhe llogari korente të përkohshme të prishur.

Pavarësisht nga këto lloj efektesh të kundërta të shkaktuara nga përshtatja e njëhershme, një tjetër eksternalitet funksionon nëpërmjet kanalit të tregtisë: nëse kërkesa dhe të ardhurat rriten si pasojë e zgjerimit fiskal të një vendi, atëherë do të rritet edhe kërkesa për importe (absorbimi) nga vendet e tjera të EMU-së (në periudhë afatgjatë). Ky eksternalitet pozitiv pjesërisht kompenzon eksternalitetet e tjera negative.

Kanali i normës së interesit

Për arsyet e përmendura më sipër, ekspansioni fiskal ka efekte inflacioniste. Por, në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar, inflacioni mund të ndalohej nga Banka Qendrore Evropiane në nivel ndërshtetëror. Në varësi të madhësisë së vendeve dhe shumës së shpenzimeve shtesë publike, BQE – duke ndjekur një objektiv inflacioni më pak se 2 për qind – do të detyrohet të rrisë normën e interesit për gjithë Eurozonën. Rritja ekonomike në gjithë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar do të pësojë një ulje. Ky është një eksternalitet i shumëpërmendur nëpërmjet kanalit të normës së interesit. Por, veç efekteve negative të rritjes, edhe normat e larta të interesit përbëjnë një kërcënim për vazhdimësinë e borxhit të vendeve të tjera. Në periudhë afatgjatë, normat e larta të interesit mund të shkaktojnë një mbibarrë të borxhit publik. Disa ekonomistë argumentojnë që eksternalitetet e normave të interesit mund të injorohen, sepse “Evropa është plotësisht e integruar në tregjet financiare botërore, kështu që huamarrja e një vendi vështirë të bëjë një përshtypje në normat e interesit botërore dhe evropiane” (Baldein and Wyplosz, 2003, f. 386.) Por, ky argumentim shpërfill një pikë shumë të rëndësishme. Pa dyshim, vendet si Irlanda ose Luksemburgu vështirë se mund të ndikojnë normat e interesit botërore apo evropiane. Madje edhe politika fiskale e Gjermanisë nuk mund ta detyrojë FED-in të ndryshojë politikën e saj. Por, BQE është një ndër tre institucionet, politika monetare e së cilës mund të ndikojë ekonominë botërore dhe për këtë arsye, ajo shikohet me kujdes të madh. Për këtë arsye, është e mjaftueshme që një vend i

Bashkimit Ekonomik dhe Monetar të ndikojë në politikën e BQE në lidhje me normën e interesit, për të influencuar ekonominë botërore.

Kanali i kursit të këmbimit të euros

Kanali i tretë është kursi i këmbimit të euros. Meqë normat e interesit ka mundësi të rriten si shkak i zgjerimit fiskal, kërkesa për euro mund të rritet dhe të ndodhë një vlerësim i euros. Ndërsa efekti mbi kursin e këmbimit është fillimisht pozitiv, zgjerimin e tepruar fiskal mund ta shkaktojë një dobësi financiare e euros nëpërmjet një borxhi të ndërprerë. Megjithatë, në periudhë afatgjatë, vlerësimi përkeqëson bilancet tregtare të vendeve të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (nëpërmjet kanalit të tregtisë) me vendet që nuk kanë pranuar euron.

Me pak fjalë, është e vështirë të identifikosh shenjat e të gjitha efekteve, sepse ekzistojnë eksternalitete negative dhe pozitive. Evidencat empirike mbi këtë çështje janë të ndara në dy pjesë, por akoma presin të shqyrtohen (Brunila, 2002, f.3). Ndërsa eksternalitetet nëpërmjet kanalit të tregtisë mund të jenë vërtetë pozitive, efektet e politikave fiskale ekspansioniste mbi inflacionin dhe kursin e këmbimit të euros, duket se janë të padëshirueshme. Kjo pikëpamje do të merret gjatë gjithë studimit.

Stimujt e ndryshuar për deficitet dhe veprimet buxhetore

Hyrja në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar ndryshon dy kushte kryesore ekonomike: së pari, normat e kursit të këmbimit me vendet e tjera të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar janë të fiksuara dhe; së dyti, norma e interesit dhe politika monetare e bankës qendrore nuk është e vendosur sipas çdo vendi, por është e vendosur në nivelin mbikombëtar për gjithë Eurozonën nga BQE.⁶ Kjo çon në një kufizim të rëndësishëm si dhe në detyra të reja për politikën kombëtare fiskale.

Dihet që në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar, politika fiskale është i vetmi instrument i mbetur në duart e politikës kombëtare për të rregulluar shock-et e tyre. Por, në Bashkimin Ekonomik

dhe Monetar, këto lloj shock-esh asimetrike madje mund të zmadhohen nëpërmjet mekanizmave të mëposhtëm: me një politikë të centralizuar të normës së interesit ndryshimet e inflacionit midis vendeve përcaktojnë koston reale të investimit. Së bashku me efektin e Balassa-Samuelson⁷, kjo nënkupton norma reale të larta interesi që dëmtojnë rritjen në vendet me ritëm të ulët të rritjes dhe norma të ulëta interesi në vendet në zhvillim. Për këtë arsye, veprimet fiskale për financimin e borxhit bëhen akoma edhe më të përshtatshme për të reaguar në situatat e këqija asimetrike. Veç kësaj, Bashkimi Ekonomik dhe Monetar krijon (anti-)stimuj të tjerë për përdorimin e tij të shtuar.

Zgjerimi fiskal ka efekte të forta

Ndërsa në rastin e një ekonomie të vetme të hapur efektet pozitive të shpenzimeve të tepruara janë pjesërisht ose plotësisht të lëna jashtë, nëpërmjet normave të larta të interesit dhe një vlerësimi të monedhës vendase, në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar një vlerësim individual i monedhës nuk mund të ndodhë. Rezultati është që efekti i dëshiruar mbi ekonominë e brendshme të një zgjerimi fiskal është më i fuqishëm (eksportet nuk rriten). Efikasiteti i përforcuar i ekspansionit fiskal shpall një stimul për rritjen e përdorimit të këtij instrumenti.


Barra fiskale

Në rastin e një ekonomie të vetme, ekspansioni fiskal është njësoj si një investim i lënë jashtë. Në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar, zgjerimi i njëjtë monetar do të shkaktojë një rritje më pak të fortë të normës së interesit të euros. Kjo ndodh, sepse (në lidhje me inflation targeting) ceteris paribus një rritje e lehtë e normës së interesit në mbarë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar, mund të shihet si një rritje e interesit të një vendi të vetëm.

Për këtë arsye, efektet e lëna jashtë janë zbutur në vendin që po rrit shpenzimet, në kurriz të rritjes së vendeve të tjera të këtij bashkimi. Pra, rreziku i pandarë i rrezikut moral në një bashkim monetar me një politikë monetare, bëhet më i qartë, sepse vendet mund të kalojnë disa vuajtje të ekspansionit fiskal të vendeve të tjera anëtare.

Rreziku i ndarë

Fakti që qeveritë me financa relativisht të brishta përballen me një çmim më të ulët të rrezikut pas hyrjes në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar, përbën një tjetër stimul. Ndërsa yield-et (që përfaqësojnë çmimin e rrezikut) mbi për shembull, letrat me vlerë të Qeverisë Italiane janë kryesisht më të larta sesa ato mbi të Gjermanisë para vitit 1998, diferencat janë ngushtuar duke qenë se ato janë të paraqitura të gjitha në euro. Kjo mund të shikohet edhe në figurën 1.



Kjo ka dy arsye: së pari, tregjet financiare janë integruar gjithnjë e më shumë. Së dyti, ndërsa çmimi i rrezikut të letrave me vlerë të qeverisë të një ekonomie të vetme reflekton: a) rrezikun e qeverisë për mospagim; dhe b) rrezikun e zhvlerësimit të monedhës kombëtare, çmimi i rrezikut të një vendi në një bashkim monetar, përfaqëson vetëm këtë të fundit nga dy aspektet, nëse kërkohet një dalje nga situata e vështirë. Italia përfiton, sepse çmimi i saj i rrezikut të mospagimit ishte shumë më i lartë se mesatarja e BE-së përpara bashkimit monetar, por që prej vitit 1998 borxhi publik i saj është bërë më i lartë.

Një politikë e shtrënguar buxhetore

Hyrja në një bashkim monetar, krijon gjithashtu antistimuj për shpenzimet e tepruara. Për shumë vende hyrja në Bashkimin

Ekonomik dhe Monetar do të thoshte heqje dorë nga dy instrumente të përshtatshme për zbutjen reale të borxhit: inflacioni-surprizë (duke ulur normat e interesit) dhe shitja e letrave me vlerë bankave qendrore kombëtare. Kjo e fundit tashmë është ekskluziviteti i BQE. Megjithatë, BQE duket se nuk e përdor atë, sepse ajo mbështet një objektiv strikt të inflacionit (dhe stok parash) dhe i bazon vendimet e saj mbi politikatat e normave të interesit në të gjithë Eurozonën. Kjo e fundit përjashtohet nga neni 104 i Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian (EC Treaty) (European Communities, 2002).

Neni 104 (1) i Traktatit të Komunitetit Evropian Art. 104 (1) EC Treaty: Lehtësitë e mbitërheqjes ose çdo tip tjetër lehtësie kreditimi me BQE ose me bankat qendrore të shteteve anëtare në favor të institucioneve apo organeve të Komunitetit, qeverive qendrore, rajonale, lokale apo autoriteteve të tjera publike, organizmave të tjerë të qeverisur nga ligji publik ose sipërmarrje publike të shteteve anëtare duhet të ndalohen, ashtu si dhe blerja prej tyre e instrumenteve të borxhit drejtpërdrejt nga BQE apo nga bankat kombëtare qendrore.

Kjo rregullore ndalon qartë çdo lloj forme të financimit monetar të deficitit fiskal dhe prandaj parandalon veprimet e shpejta inflacioniste. Kështu që, shtrëngimi i buxhetit të qeverive është siguruar akoma më shumë nëpërmjet Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

Kështu, pyetja nëse Bashkimi Ekonomik dhe Monetar përmirëson apo përkeqëson disiplinën fiskale nuk është e parëndësishme dhe krejt e paqartë.⁸ Disa evidenca empirike tregojnë se deficitet e vendeve në një bashkim monetar, kanë tendencën të jenë më të ulëta sesa ato të vendeve që nuk janë pjesë e një bashkimi monetar (Van Rompuy, Abraham dhe Heremans, 1991). Megjithatë, modelet e thjeshta janë të vogla dhe të influencuara politikisht dhe kushtet e tjera të veçanta ekonomike shumëfishohen, kështu që çdo përgjithësim duhet të interpretohet me kujdes.

Koordinimi fiskal në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar⁹

Rast për koordinim

Fakti që në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar eksternalitetet e politikave fiskale ekzistojnë, nxjerr në dukje (në njëfarë mënyre)

nevojën për koordinimin e politikës fiskale. Politika fiskale e lënë në dorë të vendeve anëtare mund të përmendet si shembull në këtë rast.¹⁰ Supozoni që ciklet e biznesit të dy vendeve anëtare të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar të jenë të sinkronizuara dhe që ekspansioni fiskal të ketë eksternalitete pozitive. Nëse të dyja vendet shpërfillin eksternalitetet e politikave të tyre, të dyja ndërmarrin veprimet e duhura për një ekonomi të pavarur. Si përfundim, zgjerimi do të ishte më i fortë. Një aspekt, i cili në përgjithësi harrohet në këtë kontekst, është se reagimi i përgjithshëm do të rritet akoma më shumë, sepse nën një kurs këmbimi të fiksuar, zgjerimi fiskal ka efekte edhe më të forta mbi ekonominë e brendshme madje edhe pas eksternaliteteve e vendeve të tjera.

Në të kundërt, nëse të dyja vendet marrin parasysh eksternalitetet pozitive, ato ka mundësi të presin për të vepruar i pari (sjellja free-riding). Në këtë rast, veprimi fiskal i përgjithshëm do të jetë më i ulët. Në mënyrë të ngjashme, veprimet e pakoordinuara fiskale me cikle të pasinkronizuara biznesesh, do të çojnë gjithashtu në rezultate të padëshiruara. Veprimet e lira në një vend do të ndezin më shumë bumin në vend tjetër. Në mënyrë alternative, shkurtimi i shpenzimeve në vendin që përjeton bumin, do të përkeqësonte krizën e vendit me performancë të keqe.

Tani, nëse dy qeveritë koordinojnë politikat e tyre fiskale, niveli optimal i shpenzimeve të lëna në dorën e tyre mund të realizohet, nëse efektet e jashtme do të vlerësoheshin në mënyrë korrekte. Kjo ka dy pasoja pozitive: shock - u mund të zbutet në mënyrë optimale (zbutja e konsumit); dhe deficitit agregat mund të kufizohet në nivelin më të ulët të mundshëm (detyrimisht “borxh i tepruar”).

Ky aspekti i fundit është veçanërisht i rëndësishëm, sepse politikat e pakoordinuara fiskale nxisin një rritje të lartë, normat e interesit të euros do të kenë nevojë të ngrihen, gjë që do të çojë në vlerësimin e euros. Një luhatshmëri e tillë i ciklit të biznesit mbart rreziqe të ndryshme për një krizë financiare në prani të një borxhi të grumbulluar të tepruar. Për këtë arsye, ndërhyrja e pakoordinuar fiskale mund të destabilizojë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar, sepse borxhi dhe luhatshmëria rriten në mënyrë të panevojshme.¹¹

3. PAKTI I STABILITETIT DHE ZHVILLIMIT TË BASHKIMIT EVROPIAN

Ashtu siç e treguam edhe në pjesët e mëparshme të këtij studimi, politika fiskale (në formën e politikës së shpenzimeve apo të taksave) dhe borxhi publik kanë një influencë mbi variablat përkatës ekonomike të Eurozonës, si për shembull, mbi stabilitetin e çmimeve ose mbi dinamikën e zhvillimit. Kështu që, lindi nevoja për mekanizma koordinimi të ngushtë dhe detyrues, domethënë mbikëqyrje shumëkombëshe e politikave fiskale të vendeve të ndryshme të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Kjo është arsyeja pse lindi Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit, i shoqëruar nga Procedurat e Buxhetit të Tepruar.

Qëllimi i Paktit të Stabilitetit dhe Zhvillimit është parandalimi i thellimit të borxheve publike në Eurozonë. Pakti i Stabilitetit supozohet të sigurojë financa të shëndosha publike në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar, në këtë mënyrë parandalon një politikë buxhetore shumë dorëlëshuar nga një prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Baza ligjore e Paktit mund të gjendet në Traktatin e Komunitetit Evropian (European Communities, 20002a), por gjithashtu edhe në “Rezolutën e Këshillit Evropian mbi Paktin e Stabilitetit dhe të Zhvillimit” (Samiti i Amsterdimit, 1997), si dhe në dy rregullore të Këshillit të Bashkimit Evropian: njëra është “rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 1466/97, datë 7 korrik 1997, mbi përforcimin e mbikëqyrjes së pozicioneve buxhetore dhe të mbikëqyrjes dhe të koordinimit të politikave ekonomike” (Këshilli i Bashkimit Evropian, 1997a), tjetra është “Rregullore e Këshillit (EC) Nr.1467/97, datë 7 korrik 1997, mbi përshpejtimin dhe qartësimin e zbatimit të procedurave të deficitit të tepruar” (Këshilli i Bashkimit Evropian, 1997b).

3.1 Bazat ligjore të Paktit të Stabilitetit dhe të Zhvillimit.

Traktati i Themelimit të Komunitetit Evropian

Traktati i themelimit të Komunitetit Evropian në vetvete përbën një bazë ligjore të rëndësishme të Paktit: Shtetet anëtare i janë besuar politikave të shëndosha publike” (neni 104 (1)). Sipas nenit 104 (2),

Komisioni Evropian supozohet të shqyrtojë, nëse raporti i deficitit të planifikuar ose aktual të qeverisë me prodhimin e brendshëm bruto tejkalon vlerën e referencës”. Për më tepër, Komisioni monitoron “nëse raporti i borxhit të qeverisë me prodhimin e brendshëm bruto e tejkalon vlerën e referencës”. Në një protokoll të bashkëngjitur Traktatit, janë specifikuar vlerat e referencës: një kufi prej 3 për qind për deficitin buxhetor sipas kriterit të PBB-së dhe një kufi prej 60 për qind për borxhin publik sipas vlerës së PBB-së - kriteri i famshëm i Mastrohut.

Në nenin 104 të Traktatit të Komunitetit Evropian përshkruhen edhe procedurat e buxhetit të tepruar. Kjo procedurë është një element i rëndësishëm i paktit dhe është përfaqësues i karakterit detyrues të paktit, i cili siguron mekanizmat sanksionues në rastet e mospajtimit. Më poshtë ne kemi hedhur më shumë dritë mbi procedurat e buxhetit të tepruar.

Pakti i Stabilitetit u pranua zyrtarisht nga Samiti i Amsterdimit në korrik 1997, kur Rezoluta e Paktit (Këshilli Evropian i Amsterdimit, 1997) ishte miratuar zyrtarisht, duke krijuar kështu një sistem sanksionesh për shtetet anëtare që dështojnë në mbajtjen e deficiteve të tyre poshtë kufirit prej 3 për qind të PBB-së, në tre vitet e fundit. Në këtë mënyrë, vlefshmëria e kriterëve të Mastrohut u shtri drejt krijimit të shtyllave të themelimit të një përkujdesje në mbarë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar që ka për qëllim disiplinën buxhetore.

Rezoluta e Këshillit Evropian mbi Paktin e Stabilitetit dhe të Zhvillimit

Sipas rezolutës të Këshillit të Evropian mbi Paktin e Stabilitetit (Samiti i Amsterdimit, 1997) shtetet anëtare “detyrojnë veten të respektojnë objektivin afatmesëm buxhetor afër bilancit ose në suficit, të përcaktuar në programet e tyre të stabilitetit ose konvergjencës”. Në vazhdim të kësaj, shtetet anëtare të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar “do të korrigjojnë deficitet e tepruara sa më shpejt të jetë e mundur menjëherë pas emergjencës së tyre; ky korrigjim duhet të mbarojë jo më vonë se një vit pas identifikimit të deficitit të tepruar”.

Ashtu si dhe sipas ligjeve të tjera të BE në përgjithësi, edhe në rastin e Paktit, Komisioni Evropian supozohet të jetë gardiani

i marrëveshjes”. Sipas rezolutës, Komisioni është i detyruar të ushtrojë të drejtën e tij të iniciativës sipas Traktatit, në mënyrë që të lehtësojë funksionimin strikt, në kohë dhe efektiv të Paktit”. Veç kësaj, Komisioni është i ngarkuar të garantojë “funksionimin efektiv të sistemit të paralajmërimit të hershëm, lançimin e shpejtë dhe zbatimin strikt të procedurave të deficitit të tepruar. Këshilli gjithashtu, është një aktor i rëndësishëm në kuadrin e Paktit: për shembull, ai është “i detyruar të vendosë sanksione, nëse një shtet anëtar pjesëmarrës në Pakt dështon në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për të përfunduar situatën e deficitit të tepruar, të rekomanduar nga Këshilli.”

Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 1466/97

Në 7 korrik 1997, Këshilli miratoi “rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 1466/97 mbi përforsimin e mbikëqyrjes së pozicioneve buxhetore dhe të mbikëqyrjes dhe të koordinimit të politikave ekonomike” (Këshilli i Bashkimit Evropian, 1997a). Neni 1 i kësaj rezolute “përcakton rregullat që kanë të bëjnë me përmbajtjen, pranimin, shqyrtimin dhe monitorimin e programeve të stabilitetit dhe programeve të konvergencës, si një pjesë e mbikëqyrjes shumëkombëshe nga Këshilli deri në parandalimin e hershëm të shfaqjes së deficiteve të tepruara të përgjithshme të qeverive”. Sipas nenit 3, shtetet anëtare të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar janë të detyruara të paraqesin rregullisht të ashtuquajturat programe të stabilitetit. Këto programe të stabilitetit duhet të përmbajnë “objektivin afatmesëm për pozicionin buxhetor afër bilancit ose në suficit dhe rregullimet përkatëse në rrugën drejt këtij objektivi për një suficit/deficit të përgjithshëm të qeverisë dhe pritjet për nivelin e përgjithshëm të deficitit të qeverisë.”

Midis detyrave të tjera, sipas nenit 5 të Rezolutës, Këshilli është i ngarkuar edhe me ekzaminimin – mbi bazën e rekomandimeve të Komisionit (dhe në kuadër të mbikëqyrjes shumëkombëshe) – “nëse objektivi afatmesëm i buxhetit në programin e stabilitetit kujdeset për një hapësirë të sigurtë, në mënyrë që të sigurojë parandalimin e një deficitit të tejkaluar. Sipas nenit 6, Këshilli ka për detyrë të paralajmërojë (rekomandojë) sipas nenit 103 (4) shtetin anëtar përkatës për të marrë masat përkatëse për parandalimin e shfaqjes së një deficitit të tepruar.

Gjithashtu, më 7 korrik 1997, Këshilli miratoi “rregulloren e Këshillit (EC) Nr.1467/97 mbi përshpejtimin dhe qartësimin e zbatimit të procedurave të deficitit të tepruar” (Këshilli i Bashkimit Evropian, 1997b). Qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje është parandalimi i deficiteve të tepruara publike “dhe, nëse kjo ndodh, korrigjimi i menjëhershëm i tyre”. Për më tepër, rezoluta qartëson detaje të ndryshme në lidhje me Procedurat e Deficitit të Tepruar, për shembull, politika e Komisionit gjatë krijimit të raporteve të tij të shteteve anëtare: Komisioni duhet të konsiderojë faktin që një teprim i vlerës së referencës që rezulton nga një rënie e thellë ekonomike të quhet si një përjashtim vetëm nëse ka një rënie vjetore të PBB-së reale në vlerën prej të paktën 2.2 për qind, në mënyrë që sanksionet të mos zbatohen.

3.2 Programet e Stabilitetit.

Pakti i Stabilitetit bazohet në një ndërthurje të parandalimit dhe të korrigjimit. Çdo vit, të ashtuquajturat programe të stabilitetit duhet të paraqiten nga secila qeveri, në mënyrë që të përcaktohen buxhete të shëndosha dhe një mbikëqyrje e rregullt – ky është elementi parandalues i Paktit. Vetëm kur është e nevojshme, zbatohen Procedurat e Deficitit të Tepruar me mekanizmat e tyre përshpejtues dhe sanksionues (pjesa korrigjuese e Paktit, shih më poshtë) (Komisioni Evropian, 2002a, f. 22.)

Në këtë kapitull, ne do të prezantojmë shkurtimisht konceptin e programeve të stabilitetit, të cilat janë thelbësore për Paktin e Stabilitetit, duke qenë se ato përfaqësojnë rregullin ku procedura e deficitit të tepruar – kjo e fundit mjaft e diskutuar në publik dhe në media – është (ose më mirë duhet të jetë) vetëm një përjashtim, sepse – siç u përmend edhe më lart – ajo zbatohet vetëm kur një shtet anëtar ka thyer realisht rregullat.

Në fazën e dytë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, shtetet që janë përgatitur për pranimin e euros duhet të paraqesin programet e konvergencës, në të cilat ato duhet të tregojnë përputhshmërinë me kriteret e Mastrohut. Pakti është i ndërtuar mbi këtë bazë dhe

prezanton programe vjetore stabiliteti (si “pasardhës” i programeve të konvergencës) për vendet e Eurozonës. Në këtë mënyrë, vlefshmëria e kriterëve të Mastrohut u shtri drejt krijimit të shtyllave të themelimit të një përkujdesjeje në mbarë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar, që ka për qëllim disiplinën buxhetore. Kështu, rregullat e hyrjes (veçanërisht kufiri i njohur prej 3 për qind të PBB-së për deficitin publik dhe ai prej 60 për qind të vlerës së PBB-së për borxhin publik) u bënë rregullat e përhershëm fiskalë në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Ato shtete që nuk kanë pranuar euron si monedhën e përbashkët evropiane, vazhdojnë të paraqesin programet e konvergencës (Komisioni Evropian, 2002, a, f.20.)

Baza ligjore e programeve të stabilitetit është rregullorja e sipërpërmendur e Këshillit Nr. 1466/97 (Këshilli i Bashkimit Evropian, 1997a), thelbi kryesor i së cilës është objektivi afatmesëm buxhetor afër bilancit ose në suficit.

Siç duket, qëllimi kryesor i paktit duket se është pozicioni i shëndoshë themelor buxhetor në kushte të rregulluara ciklikisht, në mënyrë që të krijojë hapësirë për manovra në periudha të këqija (pa thyer kufirin prej 3 për qind). Kjo është arsyeja pse Komisioni Evropian kërkon që “bilancet e rregulluara sistematikisht duhet të vazhdojnë të përdoren, veç bilanceve nominale, si një mjet për vlerësimin e pozicionit buxhetor (Komisioni Evropian, 2002a, f.20.)

3.3 Procedurat e Deficitit të Tepruar.

Procedurat e Deficitit të Tepruar, së bashku me mekanizmat përshpejtues sanksionues, janë mekanizmi kryesor korigjues i paktit, që zbatohen vetëm kur mbikëqyrja shumëkombëshe, në kuadrin e programeve të stabilitetit, ka dështuar dhe kur një shtet anëtar ka thyer rregullat realisht (domethënë thyerje e kufirit prej 3 për qind).


Baza kryesore ligjore e Procedurave të Deficitit të Tepruar është neni 104 i Traktatit të Komunitetit Evropian (Komunitetet Evropiane, 2002). Kjo është baza kryesore ligjore e këtyre procedurave dhe tema që është diskutuar më fuqishëm në publik dhe në media (mendoni vetëm procedurat aktuale kundër Gjermanisë dhe Francës). Për këtë arsye, ne do të ilustrojmë sistematikisht funksionimin e saj në figurën 2.

Ashtu siç shihet edhe në figurën 2, gjithë procedura është e bazuar në raportimin e shteteve anëtare dhe monitorimin e Komisionit. Dy herë në vit, shtetet anëtare i paraqesin Komisionit raportet kombëtare mbi të dhënat e financave publike aktuale dhe të ardhshme. Nëse shikon ndonjë rrezik të deficitit të tepruar ose ndonjë rrezik në lidhje me kërkesat që kanë të bëjnë me deficitin ose kriterin e borxhit, ai duhet të fillojë Procedurat e Deficitit të Tepruar duke përgatitur një raport. Shtetet anëtare i përgjigjen Komisionit në lidhje me këtë raport nëpërmjet një opinioni të miratuar nga Komiteti Ekonomik dhe Financiar. Nëse Komisioni vazhdon të jetë me të njëjtin mendim, ai i dërgon një rekomandim Këshillit.

Më pas i takon Këshillit të vendosë, nëse ekziston apo jo një deficit i tepruar në vendin/vendet në fjalë. Këshilli duhet të marrë një vendim shumë të rëndësishëm – një vendim, i cili duhet të jetë i bazuar në një vlerësim të plotë dhe të përgjithshëm, që mund të jetë i ndryshëm nga opinioni i Komisionit. Nëse Këshilli vendos se ka një deficit të tepruar, Procedurat e Deficitit të Tepruar bëhen një çështje periodike: Komuniteti jep direktivat për të ndrequr situatën dhe më pas vlerëson përgjigjen e shtetit anëtar. Direktivat bëhen edhe më shtrënguese nëse vihet re se vlerësimi është negativ.

Në fund, zbatohen sanksionet. Këtu hyn në lojë Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 1467/97 (Këshilli Evropian, 1997b, shih më lart). Ajo përfaqëson një tjetër bazë ligjore të Procedurave të Deficitit të Tepruar. Qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje është të përshpejtojë dhe të sqarojë zbatimin e Procedurave të Deficitit të Tepruar. Ajo përmban më shumë specifikime mbi sanksionet sesa Traktati, por, për hir të hapësirës së shkurtër të studimit, ne nuk do t'i hyjmë detajeve të mekanizmit sanksionues. Vetëm kur ka një progres efektiv në korrigjimin e deficitit të tepruar, sanksionet mund të anulohen (Komisioni Evropian, 2002a, f.25.)

Figurë 2: Procedura e Deficitit të Tepruar.



Siç u tha edhe më lart, Procedura e Deficitit të Tepruar është e mbështetur në nenin 104 të Traktatit të Komunitetit Evropian. Një element kryesor i këtij neni është paragrafi 2, sipas të cilit Komisioni Evropian supozohet të ekzaminojë “nëse raporti i deficitit të planifikuar ose aktual të qeverisë ndaj PBB-së e kalon vlerën e referencës”. Për më tepër, Komisioni monitoron “nëse raporti i borxhit të qeverisë ndaj PBB-së e kalon vlerën e referencës”. Siç u përmend edhe më parë, këto vlera reference janë specifikuar në një protokoll të bashkëngjitur Traktatit: një kufi prej 3 për qind

për deficitin publik sipas kriterit të PBB-së dhe një kufi prej 60 për qind për borxhin publik sipas vlerës së PBB-së – kriteri i famshëm i Mastroiut. Në kapitullin 6 të këtij studimi, ne do të analizojmë se deri në çfarë mase janë arbitrare këto kritere.

4. TË METAT KRYESORE TË PAKTIT TË STABILITETIT DHE TË ZHVILLIMIT

4.1 Fleksibiliteti i kufizuar i paktit: parimi “një masë i përshtatet çdo modeli” nuk mund të funksionojë.

Një nga thëniet kryesore është se parimi i paktit “një masë i përshtatet çdo modeli” kufizon fleksibilitetin e nevojshëm për të reaguar kundrejt shock-eve specifike sipas vendeve, ndërkohë që politika fiskale është i vetmi instrument kryesor ekonomik, që ka mbetur në duart e qeverive kombëtare. Kjo duket edhe më qartë në kontekstin e zgjerimit lindor të Bashkimit Evropian: shtetet e reja anëtare kanë deficite të larta buxhetore dhe nevoja më të larta për investime publike. Ndërkohë që parimi i paktit “një masë i përshtatet çdo modeli” me zor u përshtat në një bashkim prej 15 vendesh, dhe akoma më vështirë do të mund të përshtatet në një bashkim prej 25 vendesh. Një rregull i tillë fiskal nuk mund të jetë ekonomisht kuptimplotë, duke qenë se ai nuk merr parasysh diferencat në kushtet aktuale (mendonin bashkimin e Gjermanisë), tendencën për të kursyer, mosmarrjen e rrezikut etj. – të cilat ndryshojnë nga një shtet anëtar në tjetrin.

4.2 Investimet publike meritojnë një trajtim special.

Kuadri aktual i Paktit të Stabilitetit nuk merr parasysh cilësinë e financave publike: deficitin publik rrjedh nga një konsum publik i tepruar apo nga investime publike të dobishme? Pakti nuk përfshin një “rregull të artë”, i cili do të përjashtonte projektet e nevojshme të investimit publik (me shlyerje afatgjata) nga llogaritja e raportit të deficitit. Kjo mund të kuptohet si një mosbindje (disincentive) për të lançuar projektet e dobishme të investimit publik, duke qenë se sipas logjikës së paktit, investimi publik rrit deficitin buxhetor.¹²

Megjithatë, investimi publik është jetësor për një ekonomi dhe një shoqëri, duke qenë se ai zëvendëson investimin (e mangët) privat në shumë raste, ku ka kosto të larta në periudhë afatshkurtër (dhe investitorët privatë për këtë arsye zgjedhin të mos përfshihen) dhe përfitime të larta (mendonin investimin për edukimin ose infrastrukturën). Në këtë mënyrë, sektori publik jo vetëm që kontribuon në formimin dhe kalimin e stokut të kapitalit, por gjithashtu, prodhon një të ardhur të rëndësishme sociale nëpërmjet investimit publik. (Buti, Eijffinger dhe Franco, 2003, f. 11.)

Siç flitet në përgjithësi, një projekt investimi nënkupton të ardhura në të ardhmen dhe normalisht trashëgon një hendek të konsiderueshëm midis të ardhurave aktuale dhe shpenzimeve aktuale. Kostot duhet të shpërndahen në kohë, meqë dhe të ardhurat rriten në atë mënyrë. Megjithatë, Pakti nuk lejon amortizimin e shpenzimeve të investimit nga ana e qeverive. Për këtë arsye, është e rëndësishme heqja e detyrimeve mbi investimet publike në Bashkimin Evropian për dy arsye: së pari, në shumë vende të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar investimet publike kanë rënë që prej mesit të viteve '70 (investimet neto tani janë praktikisht zero në Gjermani, Itali, Belgjikë dhe Austri). Së dyti, vendi i investimeve publike duhet të jetë veçanërisht i rëndësishëm për shtetet e reja anëtare të Bashkimin Evropian nga Evropa Qendore dhe Lindore (Buti, Eijffinger dhe Franco, 2003, f.11; Blanchard dhe Giavazzi, 2003, f.4.)

4.3 Rregulli “afër bilancit ose në suficit”: efektet e pafavorshme për barazinë midis brezave.

Duke siguruar edukimin, infrastrukturën publike etj. nëpërmjet investimeve publike, sektori publik kontribuon në formimin dhe pasimin e stokeve të kapitalit. Pasimi i referohet kalimit të kapitalit të akumuluar brezit tjetër. Në këtë mënyrë, investimet publike kontribuojnë në barazinë midis brezave në drejtim të transferimit midis tyre, domethënë në vendosjen e një kontrate midis brezave.

Komisioni Evropian përdor interpretimin se buxhetet duhet të jenë “afër bilancit ose në suficit” gjatë ciklit (shih Komisioni Evropian, 2002a, f.20). Kjo do të thotë se qëllimi i Komisionit është rritja e përdorimit të bilanceve të rregulluara sistematikisht në mbikëqyrjen

buxhetore (Komisioni Evropian, 2004a, f.78).¹³ Megjithatë, kjo supozon pa dyshim që ka një *raison d'être* për buxhetet që të jenë “afër bilancit ose në suficit” gjatë ciklit. A është kështu? Ky rregull bie poshtë kur përballet me një deficit zero në një ekuilibër të përgjithshëm. Duke përdorur pak algjibrën, mund të tregohet se kjo faktikisht e çon raportin e borxhit publik drejt zeros, si pasojë e rritjes të përhershme pozitive të output-it.¹⁴ Kjo, pa dyshim nuk është në përputhje me rritjen optimale dhe barazinë midis brezave.

Siç u përmend edhe më lart, Wenzel (1992a) dhe Wenzel dhe Wrede (1993) kanë treguar që nuk ekzistojnë ekuilibra të qëndrueshëm midis rritjes (së maksimizimit të konsumit) me borxhe pozitive publike, duke nënkuptuar se borxhi dhe PBB mund të rriten së bashku pa reduktuar hapësirën e qeverisë për manovra. Për më tepër, le të kujtojmë se ka edhe arsye të tjera të mira për parandalimin e borxhit publik nga zhdukja: siç u argumentua edhe më lart, borxhi publik mund të jetë një mjet për transfertat midis brezave, ose mund të dalë në formën e projekteve të investimeve publike me të ardhura të larta sociale (Blanchard dhe Giavazzi, 2003, f.2).

Pra, në historinë e mendimit ekonomik, vështirë se gjendet ndonjë çështje që të ketë qenë aq kundërshtuese sa pro-të dhe kundër-at e borxhit dhe të deficitit buxhetor (shih për shembull, Wenzel, 1992b). Në vitin 1997 për shembull, një ndryshim i buxhetit të balancuar i propozuar Kushtetutës Federale të SHBA-së, u kundërshtua nga ekonomistët amerikanë (si Arrow, Samuelson, Solow etj.) si i panevojshëm dhe i pabazë. Këta ekonomistë theksuan se “nuk ka nevojë të vendoset kombi në shtrëngim ekonomik”.¹⁵ Ne sot e dimë që në të vërtetë nuk ka nevojë për shtrëngim fiskal. Pak më vonë, buxheti federal i SHBA kaloi në suficit, megjithëse kushtetuta nuk u ndryshua sipas mënyrës së propozuar.¹⁶

4.4 Pakti i Stabilitetit dhe i Zhvillimit neglizhon shpërndarjen optimale ndërkohore.

Në bazë të modelit të rritjes të Solow (Solow, 1956), rregulli i artë i mbledhjes së kapitalit si një rregull optimal varet jo vetëm nga teknologjia, por gjithashtu edhe nga tendenca e popullsisë për të kursyer. Nëse njerëzit e një vendi janë në përgjithësi kundër

sipërmarrjes së rrezikut, atëherë ata do të kursejnë më shumë, domethënë më shumë sesa kërkohet nga rregulli i artë. Si rezultat, do të ketë një mbigrumbullim të kapitalit, i cili nuk është maksimizimi i konsumit, as sot dhe as nesër. Në këtë rast, sektori publik duhet të marrë hua (domethënë të grumbullojë borxh publik), në mënyrë që të tërheqë kursimet private, të reduktojë mbigrumbullimin e kapitalit dhe si rrjedhim ta çojë ekonominë në një nivel më optimal. Wenzel (1994) ka treguar se huamarrja publike, në këtë kontekst, ka influencë më të madhe mbi intensitetin e kapitalit dhe mbi formimin e kapitalit sesa financimi me taksa. Problemi me paktin është se ai nuk merr parasysh këto aspekte të shpërndarjes optimale ndërkohore, duke qenë se ai kufizon borxhin publik dhe deficitet publike pavarësisht mbigrumbullimit të kapitalit në një ekonomi, dhe pavarësisht nevojës potenciale të sektorit publik për ndërhyrjen nëpërmjet huamarrjes.

4.5 Pakti i Stabilitetit është me fokus afatshkurtër, rregulli i deficitit të manipulueshëm.

Një tjetër e metë e paktit është se përqëndrimi mbi deficitin vjetor nuk siguron që vendet të përballojnë arritjen e një vlere afatgjatë (për shembull 60 për qind), ose reduktimin afatgjatë të deficiteve strukturore. Pak a shumë të ngjashme janë truket e kontabilitetit dhe masat që merren në fund të vitit fiskal për një rregullim politik vitrinash. Këto lloj veprimesh jo vetëm që thyejnë rregullat, por gjithashtu krijojnë stimuj për jotransparencë dhe pasiguri në librat publikë. Shembulli më i mirë i kësaj të fundit është rasti i qeverisjes të pazgjedhur socialiste të Pasokut në Greqi, e cila u akuzua se kishte rregulluar (duke e ulur) sistematikisht deficitin publik me afërsisht 2 pikë përqindje, në mënyrë (artificialisht) që ta mbante atë poshtë kufirit prej 3 për qind.¹⁷

Pra, ndërsa vlera e 60 përqindshit ka nevojë për një justifikim real ekonomik (në fund të fundit, ai është një objektiv arbitrar), pakti nuk siguron dot asnjë stimul për reduktimin e raportit ekzistues të lartë të borxhit me PBB-në në një periudhë afatgjatë. Të paktën para vitit 1997 ekzistonte motivimi i përmbushjes së kriteve të Mastrohut për të hyrë në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Fakti që Pakti vë theksin kaq shumë mbi kufirin prej 3 për qind, është problematik, duke qenë se interpretimi i kufirit të deficitit varet nga raportet

e borxheve të shteteve të ndryshme (të cilat faktikisht janë shumë heterogjene midis anëtarëve të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar): vendet me borxhe të larta duhet të respektojnë kufijtë më të afërt të deficitit publik sesa vendet me borxhe më të ulëta (siç do të tregohet në kapitullin 6).

Karakterit afatshkurtër i paktit gjithashtu, nënkupton që ai kategorikisht dekurajon reformat e mëdha që kërkojnë deficite të përkohshme për të siguruar një vazhdimësi afatgjatë (për shembull, reformat e pensionit). Duke u fokusuar në deficitin vjetor, pakti neglizhon detyrimet e parashikueshme të mundshme të buxhetit publik (si pasojë e sfidave demografike të shoqërive që plaken shpejt), për të cilat qeveritë nuk kanë marrë masa.

4.6 Kompozimi asimetrik i paktit dhe tendenca prociklike.

Më tej, pakti pretendohet të jetë asimetrik në dy drejtime. Së pari (dhe ndoshta më i rëndësishmi) problemi është tendenca prociklike e paktit. Kjo nënkupton që pakti “është më i fokusuar në disiplinën buxhetore gjatë tatëpjetave ciklike sesa gjatë përmirësimeve.

Ndërsa deficitit i tepruar sanksionohet, nuk ka asnjë mekanizëm efektiv përforcimi që të sigurojë sjelljen e duhur buxhetore dhe të administrojë suficitet e konsiderueshme të deficiteve gjatë kulmeve ciklike. (Brunila, 2002, f.10.) Së dyti, ndërkohë që pakti dekurajon shpenzimet e tepruara nëpërmjet sanksioneve dhe gjobave, përmbushja e kushteve ose përmirësimi nuk shpërblehen. Në këtë kontekst, ai është përshkruar vetëm shkopinij dhe në asnjë rast karrotë (Bean, 1998, f.106.)

Një shembull i kësaj është politika buxhetore e Gjermanisë dhe e Francës në vitet 1999 dhe 2000, kur – në vend të ngritjes ciklike – ato nuk mundën të konsolidonin buxhetet e tyre, por reduktuan taksat (në një rrugë financiarisht jo të përshtatshme) dhe madje rritën shpenzimet publike. Si shkak i tendencës prociklike të Paktit, dy fuqitë e mëdha të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar dështuan të reduktonin deficitet e tyre strukturore dhe rrjedhimisht, thyen kufirin prej 3 për qind, sapo filloi tatëpjeta ciklike në vitin 2001.

4.7 Pakti i Stabilitetit shpërfill qëndrimin fiskal.

Kritika e mëtejshme i referohet faktit se pakti “shpërfill qëndrimin agregat fiskal” dhe prandaj, në nivelin agregat “(një) qëndrim i pasaktë fiskal mund të ndodhë pa thyer rregullat formalisht” (Buti, Eijffinger dhe Franco, 2003, f.11), duke qenë se rezultati i agregimit të qëndrimeve të vetme kombëtare fiskale nuk prodhon domosdoshmërisht një qëndrim optimal fiskal të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Por, me një monedhë të përbashkët dhe me një politikë të përbashkët monetare qëndrimi agregat mund të jetë aktualisht variabli vendimmarrës për të siguruar përzierjen e saktë të politikave¹⁸, veçanërisht në lidhje me stabilitetin e kursit të këmbimit dhe integritetin e përgjithshëm financiar të Eurozonës. Gjithashtu, Këshilli Gjerman i Ekspertëve Ekonomikë (“Sachverständigenrat”) ankohet rreth faktit se pakti vë theksin aq shumë mbi monitorimin e deficiteve në nivel kombëtar, ndërkohë që monitorimi i zhvillimeve fiskale në Eurozonë, si një e tërë, vështirë se i njihet ndokujt (Sachverständigenrat, 2004, f.784.) Zgjidhja e dukshme e këtij problemi është ose koordinimi i politikës me gjithë kompleksitetet e nënvizuara më sipër ose përkufizimi i një qëndrimi fiskal në mbarë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Në këtë kontekst, duhet gjykuar vendosja e një deficiti buxhetor për Eurozonën si një e tërë.

4.8 Mekanizmat e pasigurtë përforcues dhe aplikimi partizan.

Një tjetër e metë e Paktit – këtë herë një problem më shumë i efektivitetit politik sesa i mungesës së racionalizmit ekonomik – ka çuar në një situatë të vështirë. Në fillim të vitit 2004, organi më i lartë i BE (Komisioni Evropian) regjistroi një ankesë kundër njërit prej organeve më të rëndësishme politike kombëtare, Këshillit të Ministrave të Ekonomisë dhe të Financave të BE (ECOFIN) përpara organit më të lartë legjislativ Evropian (Gjykatës Evropiane e Drejtësisë). Arsyeja ishte vendimi i ECOFIN në nëntor 2003, kundër zbatimit strikt të procedurave të deficitit të paktit në rastet e Gjermanisë dhe Francës. Ndërkohë që kjo ngjarje u dramatizua shpesh herë si fundi i paktit, ajo sigurisht tregon një nga dobësitë kryesore: rregullat janë subjekt i lirisë së veprimit politik të dukshëm (i ashtuquajtur zbatim partizan) dhe ka një mungesë kredibiliteti dhe efektiviteti të mekanizmave detyrues. Nuk është e çuditshme

që ECOFIN t'i ndalojë procedurat, sepse ndonjë nga anëtarët e tij mund të jetë viktimë ndonjë ditë. Një gjyqtar, të cilit i kërkohet të gjykojë veten, rrallëherë qëllon të tregohet strikt. Prandaj, ECOFIN ka kaq shumë liri veprimi dhe kufizon rolin e Komisionit Evropian si “një gardian i Traktateve”. Kjo dobëson konceptin e presionit të barabartë (ose shqyrtim i barabartë) si një mjet efektiv i koordinimit të politikës. Si pasojë, është propozuar shumë herë që një automatizim do të ishte më i dëshirueshëm, sepse mund të eliminonte çdo influencë politike mbi çështje tërësisht ekonomike (shih për shembull, Peffekoven, 2004, f.11.)

4.9 Detyrimi i vështirë në shtetet federative.

Në shumë vende (shtete federative) anëtare të Bashkimit Evropian, buxheti i qeverisë qendrore përfaqëson vetëm një pjesë të shpenzimeve të plota buxhetore. Ky është një rast për shembull, në Republikën Federale të Gjermanisë, ku buxheti i qeverisë qendrore (“Bundeshaushalt”) llogaritet vetëm sa gjysma e gjithë deficitit buxhetor, ndërsa buxhetet e institucioneve lokale (më shumë “Länderhaushalte”) llogariten sa gjysma tjetër. Pavarësisht përgjegjësisë së Qeverisë Federale Gjermane për të përmbushur kushtet e paktit, kjo e fundit me vështirësi mund të kontrollojë buxhetet lokale.

Të ashtuquajturat “pakte kombëtare të stabilitetit”, të cilat u krijuan në disa shtete anëtare të Bashkimit Evropian si pasojë e këtij problemi, shpesh kanë nevojë për mekanizma efektivë detyrues dhe sanksionim të besueshëm, por shpesh këto paraqesin edhe problemet e dështimit të koordinimit.

Për shembull, Pakti Gjerman i Stabilitetit u pranua si një procedurë e përbashkët me qëllim që të kontribuojë në arritjen e përmbushjes së kritereve të Mastrohut. Ende nuk ka një organ mbikëqyrës efektiv, procedura mbikëqyrëse nuk është e mjaftueshme dhe asnjë sanksion nuk mund të imponohet (Wissenschaftlicher Beirat beim Bundesministerium der Finanzen, 2004, f. 25.) Pakti nuk duhet të kishte hyrë në fuqi pa një garanci të mjaftueshme, sipas të cilës paktet kombëtare të stabilitetit do të siguronin funksionimin e tij në nivel evropian. Megjithatë, është e drejtë të thuhet se një komision i krijuar

së fundmi në Gjermani, u përpoq të reformonte sistemin federalist gjerman dhe në këtë kontekst ai ka vazhduar punën për bërjen e paktit pjesë të Ligjit Bazë të Gjermanisë (Grundgesetz), kështu që nivelet federale të qeverisë mund të bëhen të llogaritshme për borxhin publik dhe për sanksionet e deficitit.

5. DISA PROPOZIME TË RISHIKUARA PËR REFORMË

5.1 Një rishikim i propozimeve për reforma të prezantuara nga Komisioni Evropian.

Jo vetëm academia, por edhe vetë Komisioni Evropian ka dalë me disa propozime për reforma në lidhje me Paktin e Stabilitetit. Në një komunikatë për Këshillin dhe Parlamentin Evropian (Komisioni Evropian, 2002b,) Komisioni ka skicuar propozime në drejtim të fleksibilitetit në interpretimin e paktit, si dhe të zbatimit të përmirësuar të tij.

Në vend të këtyre propozimeve për reforma, 2 vjet më vonë (në vitin 2004) eksperiencat e ndërprera në lidhje me zbatimin e paktit që prej vitit 2002 kanë qenë zhgënjyese: në nëntor të vitit 2003, Franca dhe Gjermania ia dolën mbanë të ndalonin Procedurat e Deficitit të Tepruar që kishin filluar të zbatoheshin kundër tyre nga ana e ECOFIN – duke shpërfillur totalisht gjithë rregullat e bazuar në përqasjen “e skicuar për të përhapur rreptësinë fiskale gjermane në Evropë” (Parker, 2003, f.2.)¹⁹ Komisioni reagoi dhe ngriti një ankesë kundër ECOFIN para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Gjermania dhe Franca përsëri kanë deficite publike më të larta se kufiri prej 3 për qind në vitin 2004 dhe ka mundësi ta thyejnë prapë këtë kufi, në vitin 2005. Siç flitet në përgjithësi, rreth gjysma e vendeve anëtare të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (përfshi Italinë, Holandën, Portugalinë etj.) ka mundësi ta thyejë kufirin në vitet 2004 dhe 2005 (Komisioni Evropian, 2004a.) E gjithë kjo nxjerr në pah përsëri dobësinë e paktit dhe sqaron pse Komisioni ndjeu një nevojë të fortë të skiconte propozime me detaje të reja dhe më konkrete për reforma, në shtator të vitit 2004 (Komisioni Evropian, 2004b.) Duke pranuar “nevojën për të vepruar” në mënyrë që të ruhet Pakti i Stabilitetit, Komisioni (nën drejtimin e Komisionerit të ri për

Çështjet Ekonomike dhe Financiare) këtë herë me sa duket është më i angazhuar të prezantojë reforma reale, pavarësisht se ka qenë pjesë e kritikave nga ana e disa shteteve anëtare si Gjermania dhe Franca.

Në fillim të komunikatës së tij të shtatorit 2004, Komisioni Evropian (2004b, f.3) pohon se “gjatë viteve të fundit, janë grumbulluar tensione në zbatimin e paktit, që kanë çuar në një humbje të kredibilitetit dhe pronësisë dhe ... zbatimi i këtij kuadri ka nxjerrë në dukje nevojat për përmirësimin e tij.” Në këtë kontekst, Komisioni pranon se Bashkimi Evropian me 25 anëtarë është më heterogjen se Bashkimi Evropian “i vjetër” me 15 anëtarë. Për këtë arsye, mesazhi kryesor nga propozimet e Komisionit është lejimi i një fleksibiliteti më të lartë në zbatimin e paktit dhe “plotësimi më i mirë i diferencave në situatat ekonomike në Bashkimin Evropian” (Komisioni Evropian, 2004b, f.2.)

Përjasja e ndryshuar e Komisionit karakterizohet kryesisht nga katër elemente kryesore (Komisioni Evropian, 2004b, f.3-7):

1. Përqëndrimi më i madh mbi borxhin publik dhe vazhdimësinë, ku monitorohen pozicionet buxhetore. Kjo, para së gjithash, do të thotë që fokusi duhet të jetë i përqëndruar më shumë mbi kriterin e borxhit (kufiri prej 60 për qind) dhe mbi masat e Traktatit drejt një “hapi të kënaqshëm” për reduktimin e borxhit. “Hapi i kënaqshëm” duhet të varet nga kushtet e rritjes ekonomike aktuale sipas vendeve, një masë që duhet të jetë haptazi një element i fleksibilitetit të përforcuar. Të paktën, e gjitha kjo përaftron logjikën e propozimit që ne prezantuam në kapitullin 6 të këtij studimi, domethënë që raporti i borxhit dhe norma e rritjes ekonomike të një vendi kanë rëndësi kur përcaktohet objektivi i deficitit.

2. Marrja parasysh e kushteve specifike të vendeve gjatë përcaktimit të objektivave afatmesëm të parimit “afër bilancit ose në suficit” të buxheteve. Ndërsa në kundërshtim me argumentimin që iu bë në këtë studim (shih kapitullin 4.3), parimi “afër bilancit apo në suficit” nuk shqyrtohet në mënyrë të plotë, Komisioni të paktën pohon se si një rregull i përgjithshëm dhe i pandryshueshëm për të gjithë anëtarët e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar nuk është ekonomikisht kuptimplotë: “objektivat e njëtrajtshëm për të

gjitha vendet nuk rezultojnë të përshtatshëm dhe kanë mungesë racionalizmi ekonomik” (Komisioni Evropian, 2004b, f.4.)

3. Konsiderimi i kushteve ekonomike dhe i zhvillimeve gjatë zbatimit të Procedurës së Deficitit të Tepruar. Ky propozim ka dy efekte: së pari, kur një vend vuan nga periudha afatgjata të rritjes së ngadaltë ekonomike, atëherë mund të ketë një klauzolë përjashtuese që ndalon konsiderimin e atij shteti si një shtet që ka deficit të tepruar. Së dyti, me fillimin e Procedurës së Deficitit të Tepruar, duhet të ketë një rrugë për të korigjuar deficitin e tepruar, varur nga kushtet ekonomike dhe nivelet e borxhit në vendet respektive, domethënë “Pakti duhet të marrë më mirë parasysh kushtet ekonomike dhe bazat e thyerjes të vlerës së referencës prej 3 për qind nga ana e një shteti anëtar. Më hapur në lidhje me këtë çështje, propozimet e Komisionit ishin kërkesat e vazhdueshme të vendeve të Bashkimit Ekonomik dhe Evropian, të persektuara nga Procedura e Deficitit të Tepruar, siç ishin Gjermania dhe Franca, të cilat pretendojnë që rritja e tyre ekonomike, kohët e fundit, ka qenë e ngadaltë dhe që një Procedurë e ashpër e Deficitit të Tepruar do të ketë efektet e kundërta prociklike.

4. Garantimi i veprimeve me të hershme për të korrigjuar zhvillimet buxhetore, të cilat duken të papërshtatshme. Në këtë kontekst, një pretendim i rëndësishëm i ngritur nga Komisioni është dyshimi i tij për kapacitetin për të lëshuar drejtpërdrejt “paralajmërimet të hershme”. Kjo ide ka gjetur vendin e saj edhe në Kushtetutën e re të Bashkimit Evropian.²⁰ Duket qartë se një automatizim i tillë mund të reduktojë shkallën e lirisë politike të veprimit/zbatimit partizan dhe si rrjedhojë, do të përmirësojë zbatimin e Paktit (shih gjithashtu, kapitullin 4.8) (Komisioni Evropian, 2004b, f.3-6 dhe 8.)

Në 15 nëntor të vitit 2004, ECOFIN vendosi të diskutojë propozimet e Komisionit për reformë në lidhje me Paktin. Sipas Komisionit, Ministrat e Ekonomisë dhe Financës theksuan nevojën e parandalimit të politikave prociklike, të bërjes së kriterit të borxhit më operacional dhe të marrjes parasysh të reformave strukturore (Këshilli i Bashkimit Evropian, 2004, f.7.) Për të qenë më të saktë, një numër shtetesh anëtare (veçanërisht nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore) kërkojnë një trajtim special për shembull, për reformat

e pensionit (si pasojë e efektit të pagesave të pensionit mbi borxhin dhe raportin e deficitit). Disa shtete anëtare (si për shembull, Franca) do të preferonin të përjashtonin shpenzimet mbi kërkimet dhe zhvillimin nga deficitin publik, kurse të tjera (veçanërisht Gjermania) do të preferonin të shpërbleheshin për pagesat e tyre neto, bërë buxhetit të Bashkimit Evropian, duke u dhënë atyre të drejtën për të përjashtuar këto pagesa nga deficitin buxhetor (Hagelucken, 2004d, f.21.) Komisioni Evropian dha shenjën e parë të qartë të përqsjes së tij dhe të interpretimit të tij më fleksibël në lidhje me paktin në 14 dhjetor të vitit 2004, kur vendosi të ndërmarrë hapa të tjerë kundër Gjermanisë dhe Francës nën Procedurën e Deficitit të Tepruar (Komisioni Evropian, 2004c.).

5.2 Një rishikim i disa propozimeve për reformë të paraqitura në literaturë.

Natyrisht, shumë prej propozimeve për reformë të paraqitura në literaturë përqipen të ndreqin të paktën disa prej diferencave kryesore të paktit, të analizuara në kapitullin 4. Nga paragrafët në vazhdim është e dukshme lidhja me kapitullin 4. Në këtë studim, ne vetëm prezantojmë disa prej propozimeve më të rëndësishme dhe më intuitive ekonomikisht. Për më tepër, ne rishikojmë dhe shqyrtojmë në mënyrë kritike këto propozime. Për një rishikim më të kuptueshëm të propozimeve për reforma të paktit shih gjithashtu, edhe Buti, Eijffinger dhe Franco (2003) ose Eeag (2003).

Përfshirja e një rregulli të artë

Për të siguruar barazinë e parimit “pajua sa përdor” dhe për të inkurajuar investimet publike, është propozuar përfshirja e një rregulli të artë në pakt. Ky është një propozim veçanërisht i rëndësishëm, duke qenë se në gjithë Evropën, ekonomistët dhe politikëbërësit do të dëshironin që shpenzimet publike të kontribuonin më shumë në rritjen ekonomike dhe papunësinë (dhe si rrjedhojë edhe në reformat ekonomike të Axfordës së Lisbonës dhe në rritjen ekonomike). Kështu që, shpenzimet publike do të shpërndaheshin më shumë sipas qëllimeve të investimit dhe më pak sipas veprimeve të konsumit të thjeshtë dhe rishpërndarës. Vetëm shtetet anëtare të Bashkimit Evropian hoqën dorë nga borxhet e tyre. Për këtë arsye, investimet

publike nuk duhet të dekurajohen, siç ndodh aktualisht me rregullat ekzistues të Paktit.

Blanchard dhe Giavazzi (f.1-7) tregojnë se përballja me një deficit zero në një ekuilibër të përgjithshëm, siç nënkupton parimi “afër bilancit ose në suficit”, do ta çonte faktikisht borxhin publik në zero. Por, kjo nuk përputhet me optimalitetin e rritjes ekonomike dhe barazinë midis brezave (shih kapitulli 4.3). Autorët më pas tregojnë se kur përfshihen pagesat e interesit e zhvlerësimi dhe përjashtohen investimet neto nga buxheti (ashtu siç është praktika në kontabilitetin e sektorit privat), mbajtja e një deficiti zero në një ekuilibër të përgjithshëm, do ta çonte faktikisht borxhin publik në të njëjtin nivel me stokun e kapitalit publik. Ky rezultat siguron se stabilizatorët fiskalë mund të punojnë lirisht, se investimet publike nuk do të kufizohen²¹, madje mund të inkurajohen dhe se gjatë ciklit, huamarrja neto do të barazojë rritjen e stokut të kapitalit publik. Për më tepër, nëse borxhi publik kthehet në stok të kapitalit publik, ky i fundit duhet të ketë një objektiv në vlerë në vend të një kufiri arbitrar prej 3 për qind.

Megjithatë, jo të gjitha projektet e investimeve publike japin fryte dhe prodhojnë të ardhura cash, të cilat kërkohen nga një analizë e kujdesshme kosto-të ardhura. Për më tepër, përjashtimi i investimeve publike nga llogaritja e deficitit, mund të hapë dritare të reja për fshehjen e deficitit dhe mund të krijojë precedentë për “llogaritje krijuese”: cili lloj i shpenzimeve publike mund të quhet “investim publik”? Një rregull i tillë i artë mund të çojë në deklarin e shumë kategorive të shpenzimeve si “investime” në vend të karakterit të tyre konsumues, dhe në këtë mënyrë do të reduktojë transparencën buxhetore (EEAG, 2003, f.59.)

Rregullat për shpenzime në vend të kufijve të deficitit

Diskutimi mbi kufizimin e deficiteve dhe mbi përshtatjen e borxhit kundrejt financimit me taksa, është zbehur disi, aq sa ai nuk shqyrton më pse është i nevojshëm në fund të fundit borxhi apo financimi publik. Me fjalë të tjera, shpenzimet kryesore publike që duhet të financohen në njëfarë mënyre janë bërthama dhe baza e problemit. Disa autorë për këtë arsye propozojnë të përcaktojnë

më mirë rregullat për shpenzime sesa kufijtë e deficiteve. Këto lloj propozimesh nënkuptojnë që vetëm ana e shpenzimeve të qeverisë është e kufizuar, e pavarur nga të ardhurat e mbledhura të taksave. Argumenti vazhdon se pjesa e të ardhurave mund të kontrollohet me vështirësi në çdo rast dhe si rrjedhojë, rregullat e shpenzimeve duhet të sigurojnë përshtatshmëri me kufizimet fiskale. Për më tepër, këta lloj rregullash për shpenzimet mund të jenë më të lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u komunikuar publikut sesa shpjegimi "buxhet i rregulluar dhe i balancuar në mënyrë ciklike". Kështu që, është më e lehtë për publikun për ta quajtur qeverinë përgjegjëse për mospërbushje të rregullave buxhetorë.

Megjithatë, kur kujtojmë arsyet e ndryshme për kufizimin e deficiteve të qeverive, natyrisht rregullat në lidhje me shpenzimet dështojnë në përmbushjen e të gjitha këtyre qëllimeve. Rregullat e shpenzimeve nuk kufizojnë qëllimin e deficitit publik dhe si rrjedhojë, nuk marrin mirë parasysh efektet e këtyre deficiteve mbi anëtarët e tjerë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Me fjalë të tjera, ato nuk parandalojnë efektet e jashtme, domethënë ato nuk i referohen atyre variablave fiskale që aktualisht prodhojnë eksternalitete negative. Gjithashtu, detyrat e qeverisë mbështeten mbi të ardhurat si dhe mbi anën e shpenzimeve. Si rezultat, mund të shfaqen hilet e llogaritjes dhe një tendencë drejt taksave sesa politikave të shpenzimeve, dhe kjo mund të minojë kontrollin efektiv. Në fund, do të jetë problematike të vendosësh rregulla për shpenzimet në kontekst shumëkombësh (si për shembull, Bashkimi Ekonomik dhe Monetar). Rregullat e njëjta për shpenzime mund t'u imponojnë preferenca heterogjene vendeve që janë heterogjene nga ana politike, ndërkohë që me rregulla specifike sipas vendeve, sanksionet në mbarë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar do të jenë të vështira (Peeffekoven, 2004, f 9-10; Buti, Eijffinger, dhe Franco, 2003, f.16.)

Përcaktimi i objektivit buxhetor për Eurozonën si një e tërë

Në kapitullin 4.7, ne treguam se pakti neglizhon qëndrimin agregat fiskal në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar, i cili duhet të jetë aktualisht variabli vendimtar për të siguruar përzierjen e duhur të politikës, duke qenë se qëndrimi agregat fiskal de facto hyn në funksionin e reagimit të Bankës Qendrore Evropiane si një argument.

Në literaturë është zhvilluar ideja e përcaktimit të një qëndrimi fiskal në mbarë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Në këtë kontekst, është gjykuar vendosja e programeve të stabilitetit në Eurozonë dhe si rrjedhojë, ideja e një objektivit të deficitit buxhetor për Eurozonën si një e tërë. Në këtë rast, një objektiv mund të vendoset për gjithë Eurozonën dhe mund bëhet pjesë e gjithë shteteve anëtare. Kështu që, objektiv (kufiri prej 3 për qind) mund të aplikohet vetëm për deficitin mesatar të Eurozonës, ndërsa disa shtete do të lejohen të kenë deficite më të larta, duke ditur që ka të tjera me deficite më të ulëta se vlera e objektivit (Buti, Eijffinger, dhe Franco, 2003, f 18-19.)

Aspekti më problematik i reformës është shpërndarja e “pjesëve të deficitit”. Me sa duket, një shpërndarje burokratike (e imponuar nga disa institucione të BE) do të jetë shumë e diskutueshme. Casella (2001) sugjeron një sistem të lejes së deficitit të tregtueshëm si një alternativë për një mekanizëm politik/burokratik të shpërndarjes. Pas zgjedhjes së një objektivit agregat për Eurozonën dhe shpërndarjes fillestare të lejeve të deficitit të tregtueshëm, vendet anëtare duhet të fillojnë të tregojnë të drejtat e deficitit. Në rastin e një shock-u asimetrik të një vendi specifik, shteti anëtar A mund të blejë lejen e deficitit të tregtueshëm nga një vend B, në mënyrë që të ndjekë një politikë stabilizimi, nëse B ka një suficit buxhetor (ose një deficit poshtë vlerës objektiv).

Megjithatë, një sistem i lejes së deficitit të tregtueshëm duhet të përballet me tre probleme kryesore: së pari, në mënyrë që të lejojë tregtueshmërinë efiçente, deficitet e shteteve të ndryshme anëtare duhet të jenë plotësisht të zëvendësueshme, domethënë ato duhet të prodhojnë eksternalitete. Kjo është e vështirë, sepse shtetet anëtare ndryshojnë sipas madhësisë, sipas borxhit, etj..

Së dyti, efiçienca e tregut të lejes së deficitit të tregtueshëm varet nga fakti se sa konkurrues do të jetë ky treg. Kjo është problem, në rast se ka shumë pak pjesëmarrës si në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar (aktualisht 12). Së treti, akoma duhet të zgjidhet problemi i shpërndarjes fillestare të lejes së deficitit të tregtueshëm. Kriteret “objektiv” si PBB, popullsia etj., do të krijojnë shpërndarje shumë të ndryshme.

Delegimi i politikës fiskale një institucioni qendror

Nga pikëpamja e problemit të aplikimit partizan dhe zbatimit të pakënaqur të Paktit të Stabilitetit, kohët e fundit janë parashtruar propozimet për reforma për t'i ngarkuar përgjegjësinë e kuadrit të politikave buxhetore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, një institucioni ose komiteti qendror dhe të pavarur. Ky do të përfaqësonte një hap më tej në drejtim të depolitizimit të mbikëqyrjes fiskale në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Pyetjet që bëhen nga kontribuesit më të mëdhenj janë: nëse politika monetare evropiane iu delegua një banke qendrore të pavarur (BQE), pse politika fiskale vazhdon të përcaktohet në nivel kombëtar nëpërmjet proceseve parlamentare? A nuk duhet të mësojmë ne për vendimmarrjen e politikës fiskale prej ekperiencës së institucioneve të pavarura në fushën e politikës monetare (EEAG, 2003, f. 68)?

Natyrisht, studimet dhe artikujt mbi këtë çështje ndryshojnë sipas terminologjiave të një organi të tillë. Si EEAG (2003, f.68-73) ne do t'i referohemi atij si një komitet i politikës fiskale. Por, më shumë në literaturë diskutohet rreth kompetencave dhe vendimeve që mund t'i delegohen një komiteti të tillë. Blinder (1997) shkon edhe më tej duke i dhënë të drejtën këtij komiteti të vendosë për strukturën e taksave të vendeve anëtare. Të tjerë (Eichengreen, von Hagen, dhe Harden, 1995) janë të mendimit të delegohet vetëm përcaktimi i lëshimit të saktë të borxhit (vendimi mbi të ashtuquajturin “kufi i ndryshimit të borxhit”), në mënyrë që ta çlirojë këtë vendim të rëndësishëm nga ndikimi politik. Disa të tjerë kërkojnë vetëm delegimin e detyrave të politikave të stabilizimit (EEAG, 2003, f. 68-69.)

Kundërshtimi më i dukshëm ndaj delegimit të detyrave të politikës fiskale një komiteti të politikës fiskale është se teknokratët e pazgjedhur do të kenë lirinë e veprimit për të marrë vendime të rëndësishme politike, dhe për këtë arsye ideja e delegimit nuk do të jetë në përputhje me vendimmarrjen demokratike. Natyrisht, ky problem mund të zgjidhet, vetëm nëse komiteti i politikës fiskale bëhet subjekt i kontabilitetit demokrat. Për më tepër, sipas faktit se politika fiskale në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar është i vetmi instrument politik i rëndësishëm i mbetur në duart e qeverive kombëtare, është vështirë që shtetet anëtare të jenë të gatshme t'ia

delegojnë të drejtat e tyre një komiteti të tillë. Për më tepër, centralizimi (ose të paktën pjesërisht) i kompetencave fiskale në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar do të jetë i vështirë të përputhet me parimin e subvencionimit, me të cilin Bashkimi Evropian mburret aq shumë dhe që është pjesë e Traktatit të Komunitetit Evropian (neni 5) (shih Komunitetet Evropiane, 2002). Kështu, sa më larg që të shkojnë këto reforma, aq më i vështirë bëhet zbatimi i tyre praktik.

6. KONTRIBUTI I DISKUTIMIT TË REFORMAVE: RASTI PËR NJË PËRQASJE MË FLEKSIBLE SIPAS VENDEVE

Ashtu siç ndodh shpesh me kufijtë numerikë, kriteret e Mastrohut, në shikim të parë, duket se janë pothuajse arbitrare. Kjo është në njëfarë mënyre e drejtë, por jo plotësisht: kur negociohej versioni i Mastrohut i Traktatit të Komunitetit Evropian, mesatarja e borxhit publik arriti afërsisht 60 për qind të PBB-së. Raporti mesatar i deficitit ishte mbi 3 për qind të nivelit të kërkuar. Akoma, raporti i deficitit rrjedh nga stabilizimi i raportit të borxhit në 60 për qind të PBB-së, nëse norma e rritjes nominale të PBB-së supozohet midis vendeve anëtare, ashtu siç tregohet edhe në pohimin e mëposhtëm.

Pohim: në ekulibrin afatgjatë (gjendje konstante) koeficienti i raportit të deficitit sipas PBB-së dhe të borxhit sipas PBB-së (d/b) barazohet me shumën e normës së rritjes reale të PBB-së $g(Y^r)$ dhe inflacionin π .

Proof: With public debt B and nominal (real) GDP Y (Y^r), for the growth rate g it holds that

$$\begin{aligned} g(B/Y) &= g(B) - g(Y) \\ &= (dB/dt)/B - g(Y) \\ &= ((dB/dt)/Y)/(B/Y) - (\pi + g(Y^r)) \\ &= d/b - (\pi + g(Y^r)), \end{aligned}$$

me dB/dt si derivat i kohës së borxhit publik. Për këtë arsye, nëse $g(B/Y)=0$ në gjendje konstante rezulton se $d/b = \pi + g(Y^r)$, q.e.d.

Me një inflacion prej 2 për qind (objektivi i BQE), rritja reale e PBB-së duhet të jetë 3 për qind, në mënyrë që të arrihet norma e rritjes nominale prej 5 për qind. Vetëm atëherë raporti i borxhit mund të stabilizohet në një nivel prej 60 për qind me një raport deficitit prej 3 për qind. Rrjedhimisht, një vend si Gjermania me normë shumë të ulët të rritjes do të vërejë një nivel të borxhit që rritet vazhdimisht. Në të kundërt, vendet me norma me tendencë të lartë të rritjes si për shembull, Irlanda, mund të arrijnë një raport të qëndrueshëm të deficitit, madje dhe një raport deficitit poshtë 3 për qind. Një pikë interesante është ajo që mund të quhet “paradoksi i inflacionit”: norma e lartë e inflacionit kontribuon në përmbushjen e kriterëve e Mastrihut për borxhin/deficitin, sepse një normë e ulët inflacioni (poshtë objektivit 2 për qind të BQE) e bën aderimin në rregullat të Mastrihut më të vështirë. Kështu, kriteret e Mastrihut të kuptuara si kriteret e konvergencës që mundësojnë hyrjen në Eurozonë, vuajnë nga një mospërputhje e brendshme qëllimesh: përputhshmëria me një kriter (kriteri i inflacionit²², e vështirëson përputhshmërinë me kriteret e tjera (kriteret e borxhit/deficitit).²³

Siç e thamë edhe më lart, kufiri prej 3 për qind përmban një arbitraritet të gjerë. Në fakt, nuk ka asnjë justifikim shpjegues ekonomik përse pikërisht nga gjithë kufijtë e vendosur vetëm kufiri prej 3 për qind nuk mund të shkelet (Peffekoven, 2004, f. 10.) Në fakt, nuk ka asnjë arsytim të qartë ekonomik për këtë kufi: sipas Eichengreen (2003, f. 68) “nuk asnjë arsye që të mendosh a priori se situata të tmerrshme ekonomike do të ndodhin, nëse ky kufi shkelet... Ky kufi numerik nuk kuadrohet shumë mirë në teori”. Siç e treguam edhe më lart, ai varet nga norma e rritjes reale dhe variablat e tjerë, nëse përputhshmëria me kufirin prej 3 për qind nënkupton një borxh publik të vazhdueshëm. Në fakt, e vetmja arsye pse kufiri prej 3 për qind nuk është plotësisht arbitrar është fakti se ai mund të rrjedhë nga stabilizimi i raportit të borxhit në nivelin 60 për qind të PBB-së, sipas normës së rritjes nominale të PBB-së me 5 për qind (shih më lart). Por, në fund të fundit, stabilizimi i borxhit sipas nivelit të PBB-së në 60 për qind është një objektiv themelor i Paktit të Stabilitetit. Vendet anëtare me raporte më të larta borxhi duhet t’i konsolidojnë financat e tyre publike më mirë, domethënë ato duhet t’i mbajnë deficitet e tyre më poshtë se 3 për qind e PBB-së. Në të kundërt, vendet e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar me raporte më

të ulëta borxhi do të shpërblehen nga marzhe më të mëdha deficitit (Peffekoven, 2004, f. 10.)²⁴

Një përjasje e tillë më fleksible sipas vendeve (e cila konsiston në kushtëzimin e kufirit të deficitit mbi bazën e nivelit të borxhit dhe, gjithashtu, mbi rritjen dhe inflacionin) do të ketë disa përparësi kryesore: së pari, vendet me borxh të ulët do të kenë më shumë hapësirë për manovra gjatë situatave të këqija ekonomike. Së dyti, stimujt për politika të shëndosha buxhetore janë rritur, nëse vendet janë shpërblyer me “statusin përmirësues” në formën e një hapësire më të madhe për manovra (EEAG, 2003, f. 62-63.) Së treti, shtetet e reja anëtare (procesi i arritjes së të cilëve është shumë i rëndësishëm) do të përfitojnë në veçanti nga një përjasje e tillë, duke qenë se shumë prej tyre kanë borxhe të ulëta, por deficit të lartë.

Tabelë 1 Një përjasje më fleksibël sipas vendeve: Kufiri i deficitit i kushtëzuar nga raporti i borxhit.

| Raporti i borxhit (si përqindje e PBB-së) | Renditja e vendeve sipas borxhit | Normat e rritjes nominale e PBB-së (në përqindje), me $g(Y) = \pi + g(Y^r)$ ²⁶ |
|---|--|---|
| <10 | Luksemburg, Estoni | 6.3 (LU), 9.7 (EE) |
| <25 | Letoni, Lituani | 14.2 (LV), 8.8 (LT) |
| 25-34 | Sloveni, Irlandë | 8.1 (SI), 8.2 (IE) |
| 35-44 | Mbretëri e Bashkuar, Republika Çeke, Danimarkë, Finlandë, Republika Sllovaqe | 5.7 (UK), 8.6 (CZ), 4.2 (DK), 3.4 (FI), 8.9 (SK) |
| 45-54 | Spanjë, Poloni, Suedi | 6.4 (ES), 8.6 (PL), 4.8 (SE) |
| 55-64 | Holandë, Hungari, Austri, Portugali | 2.3 (NL), 10.1 (HU), 3.0 (AT), 3.2 (PT) |
| 65-74 | Gjermani, Francë, Maltë, Qipro | 2.9 (DE), 4.3 (FR), 4.4 (MT), 6.5 (CY) |
| 75-84 | ----- | |
| 85-94 | ----- | |
| 95-104 | Belgjikë | 4.5 (BE) |
| >104 | Itali, Greqi | 4.2 (IT), 7.4 (EL) |

Burimi : llogaritje personale; raporti i borxhit dhe norma e rritjes ekonomike janë ato që priten për vitin 2004 (të marra nga Komisioni Evropian, 2004d.)

Në tabelën 1, ne kemi grupuar 25 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, sipas raportit të tyre të borxhit (të shprehur me intervale). Kolona e tretë ilustron normat e rritjes nominale të PBB-së. Gjithashtu, tabela 1 përmban informacion mbi gjithë variablat përkatës, që ndikojnë kufirin “e lejuar” të deficitit që një vend duhet të

përballojë. Ne gjithmonë duhet të kujtojmë formulën e rëndësishme themelore:

$$g(B/Y) = d/b - (\pi + g(Y^*)),$$

e cila është një ekuacion i gjendjes konstante, nëse $g(B/Y) = 0$, atëherë edhe raporti i borxhit do të jetë i konstant. d/b duhet të marrë vlerën $3/60 = 5$ për qind, e cila nënkupton se me një normë rritjeje nominale prej 5 për qind dhe një nivel prej 3 për qind të deficitit, raporti i borxhit mund të mbahet konstant në nivelin prej 60 për qind të PBB-së (gjendje konstante).

Por çfarë ndodh nëse një shtet anëtar ka një raport borxhi më të lartë apo më të ulët se 60 për qind? Siç duket, vetëm 4 nga 25 vendet, të cilat janë relativisht të vogla, e kanë intervalin e raportit të borxhit midis 55 dhe 64 për qind. Dhe çfarë ndodh nëse një shtet anëtar ka një normë rritjeje nominale që është e ndryshme nga 5 përqindshi i pretenduar, i cili është në bazë të lidhjes $3/60$. Ekonomitë e Evropës Qendrore dhe Lindore kanë një rritje më të lartë ekonomike dhe inflacion më të lartë (ky i fundit sipas efektit të Balassa-Samuelson) sesa shtetet e vjetra anëtare – dhe të gjithë afërsisht kanë një normë të rritjes nominale të PBB-së më të lartë se 5 për qind (shih tabelën 1, kolona e tretë). Duke u nisur nga pohimi i mësipërm, me norma më të larta të rritjes dhe me inflacion më të lartë, ato mund të përballojnë deficite më të larta pa rrezikuar vazhdimësinë afatgjatë të financave të tyre publike. Rrjedhimisht, kufiri prej 3 për qind “një masë u përshtatet të gjithëve” është shumë kufizues për këto vende dhe duhet të zëvendësohet me një kufi më fleksibël (Buti, Eijffinger, Franco, 2003, f. 20.) Tani le të hedhim një vështrim më të zgjeruar tre vendeve të përzgjedhura, në mënyrë që të ilustrojmë kompozimin e parimit “një masë u përshtatet të gjithëve” dhe papërshtatshmërinë e kufirit prej 3 për qind.

Letonia: një raport shumë i ulët i borxhit dhe një rritje shumë e lartë nominale e PBB-së

Letonia hyn në grupin e vendeve me borxh të ulët, me një borxh sa 14.6 e vlerës së PBB-së në vitin 2004. Për më tepër, norma e rritjes nominale së PBB-së e kalon 5 përqindshin: në vitin 2004 rritja reale e PBB-së dhe inflacioni, përputhen me 14.2 për qind (shih tabelën

1). Tani me lidhjen e gjendjes konstante $g(B/Y)=0$, në mënyrë që të mbajë një konstante të ulët të raportit të borxhit, Letonia mund të përballojë një raport të deficitit prej 2.1 për qind (sipas normës prej 14.2 për qind të rritjes nominale).²⁶ Por, duke patur parasysh që raporti i borxhit në kuadër të paktit nuk është 5 për qind por 60 për qind, madje dhe me një raport të deficitit prej 5 për qind, raporti i borxhit të Letonisë (më pas një normë prej 20 për qind) përsëri do të qëndronte poshtë kufirit prej 60 për qind për shumë vjet ose për dekada. Kjo është veçanërisht e vërtetë nisur nga fakti se, me borxhin e rritur ndaj PBB-së, norma e lartë e rritjes nominale të vendit priret të përmbajë borxhin ndaj raportit të PBB-së gjithnjë e më shumë. Është e qartë se kufiri prej 3 për qind i vendosur nga kriteret e Mastrohut është shumë kufizues për një vend si Letonia.

Austria: një raport mesatar i buxhetit, por një rritje nominale e ngadaltë e PBB-së

Austria i përket grupit të vendeve me një raport të borxhit afër vlerës të Mastrohut prej 60 për qind të PBB-së: në vitin 2004, borxhi i përgjithshëm i Qeverisë së Austrisë arriti afërsisht 64 për qind të PBB-së. Por, norma e rritjes nominale të PBB-së së vendit është më e ulët se 5 për qind: në vitin 2004, rritja reale e PBB-së dhe inflacioni është vetëm 3 për qind (shih tabelën 1). Sipas ekuacionit $g(B/Y)=$, në mënyrë që të mbajë një raport konstant të borxhit, Austria duhet të përballojë një raport deficitit prej 1.92 për qind (sipas një norme të ulët prej 3 për qind të rritjes nominale). Teorikisht, Austria duhet të kufizojë deficitin e saj në më pak se 1.91 për qind të PBB-së, duke qenë se stabilizimi i raportit aktual të borxhit nuk është i mjaftueshëm: ai duhet të reduktohet që të kthehet përsëri poshtë nivelit prej 60 për qind. Ndryshe nga situata e Letonisë, në rastin e Austrisë, kufiri prej 3 për qind i vendosur nga kriteret e Mastrohut nuk është shumë kufizues.

Italia: një raport i lartë i borxhit, me një rritje nominale të moderuar të PBB-së

Italia ka një borxh të lartë, madje më shumë se 100 për qind të PBB-së: në vitin 2004 ai arriti në 106 për qind. Norma e rritjes nominale të vendit është e moderuar, me 4.2 për qind në vitin 2004

(shih tabelën 1). Me një rënie të rritjes nominale të kufirit prej 5 për qind dhe një raport shumë të lartë të borxhit, Italia duhet të përballojë rregulla më striktë për deficitin: me një deficit në përputhje me kriteret e Mastrohut prej 3 për qind të PBB-së (dhe një rritje nominale prej 4.2 për qind), raporti shumë i lartë i borxhit të Italisë me vështirësi do të reduktohej (do të kishte vetëm një ulje prej 1.37 për qind). Me këtë ritëm, Italia do të duhen shumë dekada për të shkurtuar borxhin poshtë nivelit prej 60 për qind. Kështu, Italia do të detyrohet të konsolidojë më shumë financat e saj publike, nëse racionaliteti themelor i kriterëve të Mastrohut do ta zhdrukë nivelin e borxhit publik prej 60 për qind të PBB-së në mbarë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar.

7. KONKLUZIONE

Në këtë studim, ne kemi analizuar efektet e borxhit publik dhe të deficiteve, dhe mbi të gjitha mënyrën se si duhet të kufizohet borxhi publik. Më pas, është nënvizuar rasti i koordinimit të politikës buxhetore në kontekstin e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. Në këtë kontekst, ne kemi treguar se duket që ka një *raison d'être* për disa lloj koordinimesh të politikave buxhetore. Por, nëse është kështu, a duhet të jetë në formën e Paktit të Stabilitetit? Cilët rregulla janë të qëndrueshëm dhe eficientë? Pas një prezantimi të shkurtër të kuadrit të paktit, ne rishikuar në mënyrë kritike të metat kryesore të tij si dhe propozimet më të rëndësishme për reforma, aktualisht të diskutuara në literaturë. Në fund, ne prezantuam rastin për një përqasje më fleksible vend-pas-vendi. Ky argumentim është thelbësor për këtë studim, duke qenë se një nga të metat më të dukshme të kuadrit aktual të paktit është parimi “një masë i përshtatet çdo modeli” dhe kufiri pothuajse arbitrar prej 3 për qind. Duke qenë se pakti shpërfill faktin që shtetet janë të ndryshme, ai kufizon fleksibilitetin e nevojshëm për udhëheqjen e politikave fiskale specifike sipas vendit, inflacionit dhe rritjes ekonomike. Nërkohë që kjo ishte problematike tashmë në një Bashkim Evropian me 15 anëtarë, duket se do të jetë edhe më problematike në një bashkim me 25 vende, duke marrë parasysh dhe faktin se variablat ekonomike të shteteve të reja anëtare si për shembull rritja reale e PBB-së, inflacioni dhe borxhi publik ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga ato të vendeve të vjetra

anëtare, si pasojë e procesit të tyre të tranzicionit dhe të arritjes së standardeve.

Megjithatë, jo vetëm vendet e reja anëtare meritojnë një trajtim specifik sipas pozitës së tyre. Gjithashtu edhe Gjermania meriton një trajtim të tillë për dy arsye: së pari, goditja e fortë financiare e shkaktuar nga bashkimi i Gjermanisë duhet të merret parasysh në njëfarë mënyre. Që prej bashkimit, 1200 bilionë euro janë transferuar drejt Gjermanisë Lindore. Madje edhe sot, afërsisht 85 bilionë euro transferohen drejt Lindjes, më shumë se 4 për qind e PBB-së së Gjermanisë Perëndimore. Natyrisht, kjo është një situatë shumë e veçantë me të cilën asnjë nga shtetet anëtare nuk është përballur. Për më tepër, këto rrjedhje financiare drejt Gjermanisë Lindore gjithashtu, ndodhin në interes të integritimit evropian dhe të objektivitetit të Bashkimit Evropian për kohezionin ndërrajonal. Natyrisht, Gjermania nuk do të ketë asnjë problem të përmbushë kufirin prej 3 për qind, nëse nuk do të ishin këto transaksione që kryhen nga bilanci i përgjithshëm i qeverisë. Së dyti, pagesat e larta neto të Gjermanisë ndaj buxhetit të Bashkimit Evropian (afërsisht 0,25 për qind të PBB-së së Gjermanisë në vitin 2002) rrisin natyrisht deficitin e saj publik, ndërsa marrësit si Spanja (të ardhurat neto të të cilave arritën afërsisht 1.3 për qind të PBB-së në vitin 2002) përfitojnë nga këto fonde për të përmirësuar bilancin e tyre të përgjithshëm të qeverisë. Kështu që, është e vlefshme të konsiderojmë marrjen parasysh të pagesave neto dhe të të ardhurave neto kur llogaritim deficitin. Ky do të ishte një hap i mëtejshëm në drejtim të një interpretimi më fleksibël dhe sipas vendeve të paktit.

Ne nuk kërkojmë përjashtimin e shumë zërave (më shumë sipas vendeve) nga llogaritja e shifrave të deficitive. Kjo do të krijonte një situatë, në të cilën çdo shtet anëtar do të përpiqej të përmbushte dëshirat e veta dhe Pakti i Stabilitetit do të zhdukej totalisht. Në kapitullin 6 të këtij studimi, ne kemi përshkruar një rast të qartë për një interpretim më fleksibël sipas vendeve të paktit, të varur nga borxhi publik (i cili në çdo rast është më i rëndësishëm për një vazhdimësi fiskale afatgjatë dhe stabilitet të çmimeve sesa deficitin vjetor), rritja reale e PBB-së dhe inflacioni në shtetet e veçanta anëtare. Në këtë kontekst, propozimet më të fundit për reformë të Komisionit Evropian (për t'u përqendruar më shumë mbi borxhin

publik dhe vazhdimësinë, për të marrë më mirë në konsideratë kushtet specifike të vendeve dhe zhvillimet e tyre etj.), të cilat janë rishikuar në kapitullin 5.1, janë në drejtimin e duhur – por jo shumë të qarta. Thirrjet e identifikuara si “paradoksi i inflacionit” janë për konsiderimin më të lartë të diferencave të inflacionit midis vendeve anëtare. Për më tepër, kërkesa e fundit e Kancelarit Gjerman Schroder, për të marrë parasysh pagesat neto të Gjermanisë dhe të vendeve të tjera dhënë buxhetit të Bashkimit Evropian, meriton një konsideratë më të kujdesshme, sepse do të ishte e çuditshme që kontribuesit më të mëdhenj të buxhetit të Bashkimit Evropian të dënoheshin për pagesat e tyre të larta.

LITERATURE

Amsterdam European Council (1997): Resolution of the European Council on the Stability and Growth Pact. Amsterdam European Council Presidency Conclusions, Annex 1 (European Council Resolutions on Stability, Growth and Employment). Amsterdam. 16 and 17 June 1997.

Balassa, Bela (1964): The Purchasing-Power Parity Doctrine: A Reappraisal. Journal of Political Economy, 72, 6 (Dec. 1964), pp. 584-596.

Balassone, Fabrizio, and Daniele Franco (2000): Public Investment, the Stability Pact and the Golden Rule. Fiscal Studies 21 (2), pp. 207-229.

Baldwin, Richard E., and Charles Wyplosz (2003): The Economics of European Integration. McGraw-Hill. London.

Bean, Charles R. (1998): Discussion, of: Barry Eichengreen and Charles Wyplosz (1998): The Stability Pact: more than a minor nuisance. Economic Policy, Vol. 13, Issue 26, pp. 104-107.

Blanchard, Olivier, and Francesco Giavazzi (2003): Improving the SGP through a proper accounting of public investment. Revised, Mimeo (January 2003).

Blinder, Alan S. (1997): Is Government Too Political? Foreign Affairs, November/December 1997, pp. 115-126.

Brunila, Anne (2002): Fiscal Policy: Co-ordination, Discipline and Stabilisation. Paper for the meeting of the Group of Economic Analysis of the European Commission. 16 April 2002.

Buti, Marco, and André Sapir (1998): Economic Policy in EMU: A Study by the European Commission Services. Oxford University Press. Oxford/New York.

Buti, Marco, Sylvester Eijffinger, and Daniele Franco (2003): Revisiting the Stability and Growth Pact: grand design or internal adjustment? Economic Paper, Number 180. January 2003. European Commission. Brussels.

Casella, Alessandra (2001): Tradable Deficit Permits. In: Brunila, Anne, Marco Buti and Daniele Franco (eds.): The Stability and Growth Pact – The Architecture of Fiscal Policy in EMU, pp. 394-413. Palgrave. Basingstoke.

Council of the European Union (1997a): Council Regulation (EC) No 1466/97 of 7 July 1997 on the strengthening of the surveillance of budgetary positions and the surveillance and coordination of economic policies. Official Journal L 209 , 02/08/1997 p. 0001 - 0005.

Council of the European Union (1997b): Council Regulation (EC) No 1467/97 of 7 July 1997 on speeding up and clarifying the implementation of the excessive deficit procedure. Official Journal L 209 , 02/08/1997 p. 0006

- 0011.

Council of the European Union (2004): Press Release 2617th Council Meeting Economic and Financial Affairs. 14429/04 (Presse 313) Provisional Version. Brussels, 16 November 2004.

De Haan, Jakob, Jan-E. Sturm and B. J. Sikeken (1996): Government Capital Formation: Explaining the Decline. Review of World Economics, 132, 1, pp. 55-74.

Dietzel, Carl (1855): Das System der Staatsanleihen im Zusammenhang der Volkswirtschaft betrachtet. J.C.B. Mohr. Heidelberg.

EEAG (2003): Report on the European Economy. European Economic Advisory Group at CESifo.

Eichengreen, Barry (2003): Institutions for Fiscal Stability. CESifo Forum, Vol. 4, No. 2 (Summer 2003), pp. 68-72.

Eichengreen, Barry, Jürgen von Hagen, and Ian Harden (1995): Hurdles too High: Improving Budget Procedures Is the Best Preparation for EMU. Financial Times (28 November 1995), p. 16.

European Commission (2002a): Co-ordination of economic policies in the EU: a presentation of key features of the main procedures. Euro Papers No. 45. Brussels.

European Commission (2002b): Strengthening the co-ordination of budgetary policies. Communication from the Commission to Council and the European Parliament. COM (2002) 668 final. Brussels.

European Commission (2004a): Public Finances in EMU 2004. A Report by the Commission Services. SEC(2004) 761.

European Commission (2004b): Strengthening economic governance and clarifying the implementation of the Stability and Growth Pact. Communication from the Commission to the Council and the European Parliament. COM(2004) 581 final. Brussels.

European Commission (2004c): Commission sees Germany and France on track to correct their excessive budget deficit in 2005. Press release IP/04/1471. Brussels, 14 December 2004.

European Commission (2004d): The Economy for the euro area, the European Union, and Candidate countries in 2004 – 2006. Economic Forecasts, Autumn 2004.

European Communities (2002): Treaty establishing the European Community (consolidated text). Official Journal C 325 of 24 December 2002.

Eurostat (2004): Free data. <http://europa.eu.int/comm/eurostat/>.

Gros, Daniel (2004): The Maastricht Criteria after Enlargement: Old Rules for New Members? Paper Prepared for the XVI Villa Mondragone

International Economic Seminar on "Rules, International Economy and Growth". CEIS-University of Rome "Tor Vergata". June 23rd-24th 2004.

Hagelüken, Alexander (2004a): *Athen meldete jahrelang falsche Zahlen nach Brüssel. Süddeutsche Zeitung* Nr. 219 (21.09.2004), S. 1.

Hagelüken, Alexander (2004b): *Der Euro-Betrug. Süddeutsche Zeitung* Nr. 222 (24.09.2004), S. 4.

Hagelüken, Alexander (2004c): *Griechenland log sich in die Währungsunion. Süddeutsche Zeitung* Nr. 266 (16.11.2004), S. 21.

Hagelüken, Alexander (2004d): *Finanzminister durchlöchern Stabilitätspakt. Süddeutsche Zeitung* Nr. 267 (17.11.2004), S. 21.

Hume, David (1777): *Essays and Treatises on Several Subjects.*

Parker, George (2003): *Ministers conduct late-night burial for EU fiscal framework. Financial Times* (26 November 2003), p. 2.

Peffekoven, Rolf (2004): *Statt Reform des Paktes ist seine strikte Anwendung geboten. Wirtschaftsdienst, Heft 1, Januar 2004, S. 7-11.*

Sachverständigenrat (zur Begutachtung der gesamtwirtschaftlichen Entwicklung) (2004): *Erfolge im Ausland – Herausforderungen im Inland. Jahresgutachten 2004/05. Wiesbaden.*

Samuelson, Paul A. (1964): *Theoretical Notes on Trade Problems. Review of Economics and Statistics* 46, 2 (May 1964), pp. 145-154.

Schlötzer, Christiane (2004): *Schönheit vor Wahrheit. Süddeutsche Zeitung* Nr. 222 (24.09.2004), S. 2.

Solow, Robert M. (1956): *A Contribution to the Theory of Economic Growth. Quarterly Journal of Economics*, 70, pp. 65-94.

Van Rompuy, Paul, Filip Abraham, and Dirk Heremans (1991): *Economic Federalism and the EMU. European Economy, Special Edition. European Commission. Brussels.*

von Hagen, Jürgen, and Susanne Mundschenk (2001): *The Functioning of Economic Policy Coordination. ZEI Working Paper B 08.*

von Stein, Lorenz (1871): *Lehrbuch der Finanzwissenschaft. 2. durchaus umgearb. u. sehr verm. Aufl. Brockhaus. Leipzig.*

Wenzel, Heinz-Dieter (1992a). *Existenz und Stabilität von Wachstumsgleichgewichten – Eine graphische Analyse der Steady States einer geschlossenen Ökonomie mit Staat. Volkswirtschaftliche Diskussionsbeiträge* 56. Universität Bamberg. Bamberg.

Wenzel, Heinz-Dieter (1992b): *Nutzen und Kosten der Staatsverschuldung zur Finanzierung der deutschen Einheit. In: Bock, Teresa (Hrsg.): Schriften des Vereins für öffentliche und private Fürsorge. Allgemeine Schrift* 269, S. 336-353.

Wenzel, Heinz-Dieter (1994): *Staat und Wachstum. Grundlegende Zusammenhänge zwischen staatlicher Aktivität und gesamtwirtschaftlicher Kapitalbildung*. In: Engelhard, Johann und Heinz Rebkugler (Hrsg.): *Strategien für nationale und internationale Märkte. Konzepte und praktische Gestaltung*. Gabler. Wiesbaden. S. 351-378.

Wenzel, Heinz-Dieter, and Matthias Wrede (1993). *Golden Rule Fiscal Policy*. *Schweizerische Zeitschrift für Volkswirtschaft und Statistik* 129. S. 123-150.

Wissenschaftlicher Beirat beim Bundesministerium der Finanzen (2004): *Verbesserungsvorschläge für die Umsetzung des Deutschen Stabilitätspaktes. Stellungnahme*. Schriftenreihe des Bundesministeriums der Finanzen, Band 75. August 2003. Berlin.

Wyplosz, Charles (1991): *Monetary Union and Fiscal Policy Discipline*. *European Economy, Special Edition*. European Commission. Brussels.

SHËNIME

* Heinz-dieter.Wenzel: Profesor në Universitetin Bamberg.heinz-dieter. Wenzel@sowi.uni-bamberg.de

** Joerg Lackenbauer: Universiteti Bamberg.
joerg.lackenbauer@sowi.uni-bamberg.de

*** Klaus Broesamle: Universiteti Bamberg.
klaus.broesamle@web.de

¹ Përkthim personal i autorit.

² Në fakt media shpesh raporton në këtë mënyrë.

³ Përkthim personal i autorit.

⁴ Një kategorizim i llojeve të ndryshme të eksternaliteteve është propozuar nga von Hagen dhe Mundschenk (2001). Ato ndryshojnë midis 1) eksternaliteteve horizontale, ku politika e një vendi ndikon drejtpërdrejt ekonominë kombëtare të një vendi tjetër; 2) efekteve mbi “të mirat e klubit”, ku politika e një vendi ndikon një variabël shumë të shpërndarë ose një institucion (kursin e këmbimit në euro, nivelin e çmimeve në euro ose tregun e zakonshëm). Për të mënjeluar konfuzionin, ky tekst përdor vetëm sinonimet “spillovers” dhe “externalities”.

⁵ Kushti i Marshall-Lerner tregon rrethanat që çojnë në një përmirësim ose përkeqësim të bilancit të pagesave të një vendi, nëse kursi i këmbimit të vendit përkatës ndryshon. Ai konstaton se “në qoftë se shuma e koeficientëve të kërkesës së elasticitetit të çmimit për eksporte dhe importe është më e madhe se 1, atëherë një rënie në kursin e këmbimit do të reduktojë deficitin, ndërkohë që rritja në kursin e këmbimit do të reduktojë suficitin”. Nëse kushti i Marshall-Lerner nuk plotësohet dhe shuma e kërkesës së elasticitetit të çmimeve për eksporte dhe importe është më e vogël se 1, atëherë një rënie në kursin e këmbimit do të shkaktojë një përkeqësim të bilancit të pagesave.

⁶ Vini re që një analizë e veçantë e eksternaliteteve fiskale nën një kurs të fiksuar këmbimi dhe politikë kombëtare monetare mund të bëhet, por kjo nuk është e nevojshme këtu. Këtu është e mjaftueshme të vërejmë që ekonomitë e ndërlidhura fort (madje pa një bankë të zakonshme qendrore) ka mundësi të jenë të ekspozuara ndaj eksternaliteteve të ngjashme si shkak i korrelacioneve të kursit të këmbimit dhe i marrëdhënieve intensive tregtare.

⁷ Sipas efektit Balassa-Samuelson (të shfaqur në kontributet kryesore nga Balassa (1964) dhe Samuelson (1964)), rritja e prodhimit në një sektor të hapur (mallra të tregtueshëm) zakonisht kapërcen atë të sektorit të strehimit (mallra të patregtueshëm). Duke qenë se pagat pritet të jenë të njëjta në të dy sektorët, rritja më e shpejtë e prodhimit në një sektor të hapur çon në rritjen e pagave në të gjithë sektorët. Për këtë arsye, nëse rritja e prodhimit në një vend (për shembull, Hungari) lë pas atë të një vendi tjetër (për shembull, Gjermani), atëherë inflacioni i përgjithshëm do të jetë më i lartë në vendin e parë (domethënë në Hungari).

⁸ Wyplosz (1991) jep një përmbledhje të mirë.

⁹ Literatura shpesh përdor “koordinimin” si një term çadër për një rishikim, dialog dhe shkëmbim opinioni si dhe një veprim i përbashkët (shih Komisioni Evropian (2002), f. 3).

¹⁰ Arsyetimi i prezantuar këtu ndjek Baldwin dhe Wyplosz (2003, p. 385).

¹¹ Përveç argumenteve në favor, ka dhe shumë të tilla kundër koordinimit: së pari, proceset e vendimmarrjes qeveritare për të lançuar një fushatë shpenzimesh ose për të reduktuar taksat në një periudhë të rënies ekonomike; këto vonesa duhet të zgjaten nëse vendimet mbi shpenzimet e lëna në dorë të vendeve duhet të koordinohen me qeveritë apo institucionet e tjera (Brunila, 2002, f. 7). Së dyti, “një variancë e lartë e strukturave ekonomike, institucioneve dhe situatave ekonomike midis vendeve anëtare do ta bënte koordinimin e veprimeve të politikave fiskale më komplekse (Brunila, 2002, f. 8). Prandaj, kostot e transaksionit, që rriten kur çdo qeveri dërgon informacion mbi praktikat kombëtare dhe rajonale, strukturat dhe kushtet e autoritetit qendror, do të luajnë një rol të rëndësishëm. Për të bërë një vlerësim të saktë të faktorëve të sipërpërmendur, janë të nevojshme evidenca të tjera empirike më të buesueshme. Nëse koordinimi i politikës fiskale, i lënë në dorë të vendeve, është i gjerë, kjo varet nga fakti se si vlerësohen eksternalitetet për më tepër, është e rëndësishme të marrim parasysh shkallën sipas të cilës duhet të koordinohen veprimet e shpenzimeve. Për shembull, planifikimi në mbarë Bashkimin Ekonomik dhe Monetar do të sjellë pengesa më të mëdha sesa një informim i thjeshtë i qeverive të tjera para kohe.

¹² Balassone dhe Franco (2000) tregojnë nëpërmjet një modeli me dy periudha kohore që vendosja e një kufiri “dyshe” të deficitit (si për shembull, kufiri prej 3 për qind i PBB-së) mund të çojë në

një reduktim të investimeve publike, domethënë në kontributin e sektorit publik drejt akumulimit të kapitalit.

¹³ Në një periudhë të dhënë t , CAB përftohet duke zbritur c_t (komponentin ciklik) nga bilanci aktual i buxhetit te raporti i PBB-së, b_t :

$$CAB_t = b_t - c_t = \frac{B_t}{Y_t} - \epsilon * \frac{Y_t^R - Y_t^{RP}}{Y_t^{RP}},$$

ku B_t është bilanci nominal dhe Y_t është PBB nominale. c_t , komponenti ciklik, konsiston në dy elemente: së pari ϵ , i cili është parametri i “ndjeshmërisë së buxhetit”, duke treguar se si buxheti reagon ndaj pozicionit ciklik të ekonomisë. Së dyti, një masë e këtij pozicioni ciklik: hendeku i output-it, i përkufizuar si diferenca e përqindjes midis y_t^R aktuale dhe y_t^{RP} potenciale (Komisioni Evropian, 2004a, f. 79).

¹⁴ Krahasoni pohimin në kapitullin 6.

¹⁵ Në Konferencën e Shoqatës Aleate të Shkencave Sociale (the Allied Social Sciences Association) (ASSA) në New Orleans në janar 1997, qarkulloi një tezë e Robert Eisner, Robert M. Solow dhe e James Tobin duke përdorur këtë formulim.

¹⁶ SHBA gjithashtu, ka një histori të përpjekjeve të vazhdueshme për të kontrolluar deficitin buxhetor: tashmë në 1985, qëllimi i ligjit të Gramm-Rudman-Holling ishte të kontrollonte deficitin e shkallëzuar duke i dhënë Kontrollorit të SHBA të drejtën të shkurtonte shpenzimet, nëse Presidenti dhe Kongresi nuk reduktojnë deficitin. Megjithatë, ky ligj u deklarua menjëherë antikushtetues. Një ndryshim i ligjit në vitin 1990 ndryshoi fokusin e tij nga reduktim i deficitit në kontroll të shpenzimeve. Në vitin 1996, një ligj që përcaktonte një veto presidenciale të kufizuar, u miratua nga Kongresi, por në vitin 1998 edhe ky ligj u shpall antikushtetues, gjithashtu.

¹⁷ Siç duket Greqia ka thyer vazhdimisht kufirin prej 3 për qind që prej vitit 2000 deri në vitin 2003 (kur deficitin u rrit nga 4.6 për qind e PBB-së, krahasuar me 5.7 për qind që pritej për 2004 (!)) domethënë deri tani Greqia asnjëherë nuk i ka zbatuar rregullat e Paktit të Stabilitetit (shih gjithashtu kapitullin 1).

¹⁸ Gjithashtu edhe Komisioni Evropian i referohet qëndrimit agregat fiskal në kontekstin e sigurimit të përzierjes së saktë të politikave. Shih: Komisioni Evropian (2004, f. 20.)

¹⁹ Kjo ngjarje shpesh është quajtur si “vdekja e paktit”. Një ditë

më pas “Financial Times” boton kryeartikullin me titull: “Ministrat natën vonë përgatitën varrezën e kuadrit fiskal të BE.” (Parker, 2003, f. 2.)

²⁰ Kushtetuta e re e Bashkimit Evropian është nënshkruar nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të shumë shteteve evropiane në Romë, më 29 tetor 2004, por akoma nuk është miratuar nga parlamentet kombëtare dhe referendumet kombëtare.

²¹ Sipas evidencave empirike investimet publike janë shkurtuar më shumë sesa shpenzimet (sidomos në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar) shih për shembull, De Haan, Sturm, dhe Sikken (1996), dhe Balassone dhe Franco (2000).

²² Kriteret e Mastroiut në lidhje me konvergencën e inflacionit përcaktojnë se maksimumi i lejuar për normën e inflacionit nuk mund të jetë më i lartë se 1.5 pikë përqindjeje mbi mesataren e tre vendeve më të mira të Bashkimit Evropian.

²³ Një tjetër konflikt qëllimesh lidhur me kriteret e Mastroiut mund të trashëgohet nga efekti Balassa-Samuelson në vendet e reja anëtare të Bashkimit Evropian nga Evropa Qendrore dhe Lindore: shumë prej këtyre vendeve mund të përballen me dilemën nëse duhet të zbatojnë politikën kufizuese në lidhje me inflacionin gjatë periudhës për kualifikim në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar apo të pranojnë që monedha e përbashkët mund të pranohet vetëm në një fazë të dytë më të largët. (Gros, 2004, f. 1.)

²⁴ E thënë më qartë, mbajtja e qëndrueshme e raportit të borxhit (B/Y) në gjendjen e tij konstante është një objektiv shumë i ndryshëm që faktikisht e çon atë në zero, sipas parimit “afër bilancit ose në suficit”.

²⁵ I llogaritur si shuma e ndryshimit të përqindjes së PBB-së reale (mbi vitin paraardhës) plus ndryshimin e përqindjes së deflatorit të PBB-së (mbi vitin paraardhës), të dyja nga vlerësimet e vitit 2004 (tetor 2004).

²⁶ Kjo për shkak se, siç e parashtron EEAG (2003, f. 62), “rritja nominale e PBB-së prirret automatikisht të pakësojë borxhin ndaj raportit të PBB-së në më pak se kjo përqindje, duke kërkuar deficite më të ulëta nëse raporti nuk është në rritje.”

